



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 444 Akti

Nr. 516 Vendimi
Tiranë, më 3.3.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 1.3.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ervin Beqiri**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V Ë R E N :

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Ervin Beqiri është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit Ervin Beqiri, u shortua në datën 16.12.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Pamela Qirko dhe anëtarë komisionerët Etleda Çiftja dhe Roland Ilia. Trupi gjykues zgjodhi në vijim kryesues për këtë çështje komisioneren Etleda Çiftja. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

3. Në vijim, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.
4. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji, në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e tij, deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Procedura e rivlerësimit filloi bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016 dhe u krye një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, i pavarur nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë.
7. Lidhur me ecurinë e fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Ervin Beqiri, trupi gjykues vendosi që procesi i rivlerësimit të bazohet në 1 (një) kriter të rivlerësimit dhe, konkretisht, vlerësimin e pasurisë, duke i komunikuar subjektit rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 13.1.2022 dhe duke i dhënë afat deri në datën 28.1.2022.
8. Në vijim, subjekti rivlerësimit tërhoqi dokumentacionin me dosjen e hetimit dhe në datën 18.1.2022 paraqiti një kërkesë për prova të reja dhe thirrjen e dëshmitarëve, për të cilën trupi gjykues u përgjigj, duke e njoftuar subjektin për vendimin nr. 3, datë 20.1.2022, për mospranimin e kërkesës së tij.
9. Në datën 27.1.2022 subjekti rivlerësimit paraqiti një kërkesë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve/prapësimeve të tij, të cilën trupi gjykues e pranoi duke i dhenë afat deri në datën 7.2.2022.
10. Në datën 7.2.2022 subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit si dhe paraqiti tri kërkesa: (a) për konstatimin e arritjes së nivelit të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe hapjen e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit; (b) për administrimin e provave shkresore dhe kryerjen e një analize të re financiare në kuadër të hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë; (c) për marrje të informacionit dhe provave që ishin të pamundura për t'u administruar.
11. Trupi gjykues, pasi vlerësoi kërkesat e subjektit të rivlerësimit, çmoi se deri në këtë fazë të hetimit provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë, parashikuar kjo në pikën 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", duke informuar subjektin e rivlerësimit. Në vijim, trupi gjykues shprehet se nëse me shpjegimet dhe provat, të cilat mund të paraqiteshin gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, do të provohej e kundërta e këtyre rezultateve, trupi gjykues, pasi t'i vlerësonte ato, do të vendoste lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit.
12. Në vijim, trupi gjykues ftoi z. Ervin Beqiri për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike në datën 10.2.2022.
13. Subjekti rivlerësimit paraqiti në Komisionin, në datën 9.2.2022, një kërkesë protokolluar me nr. *** prot., për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues.
14. Komisioni, me vendimin nr.3, datë 9.2.2022, shortoi trupin gjykues që do të vlerësonte kërkesën e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i zgjedhur me short, vendosi në datën 10.2.2022 pranimin e pjeshëm të kërkesës së subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri, duke vendosur përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko nga shqyrtimi i mëtejshëm i dosjes së

subjektit të rivlerësimit dhe rrëzimin e kërkesës së tij për përjashtimin e anëtarëve të tjerë të trupit gjykues. Në vijim, është informuar subjekti i rivlerësimit lidhur me vendimmarrjen.

15. Në datën 11.2.2022 është njoftuar subjekti i rivlerësimit mbi përbërjen e trupit gjykues dhe anëtarin zëvendësues Valbona Sanxhaktari, duke kërkuar edhe deklarin e konfliktit të interesit, për të cilin ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi.

16. Anëtari zëvendësues, pasi ka lexuar dosjen e hetimit administrativ të xhvuilluar e është njohur me të, ka vlerësuar se ajo nuk ka nevojë për hetime shtesë, duke kërkuar që të vijohet me seancën dëgjimore, e duke rezervuar të drejtën të shprehet për rishikim e rezultateve të hetimit pas dëgjimit të subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike.

17. Në datën 15.2.2022 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një kërkesë për pavlefshmëri të hetimeve dhe rezultatit të hetimit të realizuar nga trupi gjykues i mëparshëm. Trupi gjykues ka vlerësuar kërkesën në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, duke vendosur mospranimin e saj, mbështetur edhe në arsyetimin se anëtari zëvendësues i futur rishtazi në këtë proces, pasi është njohur me dosjen e hetimit dhe rezultatet e hetimit, ka çmuar se është dakord me to dhe nuk kërkon veprime të tjera shtesë, duke vlerësuar të shkojë në seancë dëgjimore për të dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

18. Në vijim, në datën 17.2.2022, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë në versionin *hard copy* dhe me inventar në protokollin e Komisionit, dokumentet e depozituara në vijim të rezultateve të hetimit, të cilat ai i ka depozituar në datën 21.2.2022.

19. Në datën 23.2.2022 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një kërkesë për rikryerjen e një analize të re financiare në kuadër të hetimit administrativ në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Trupi gjykues ka vlerësuar këtë kërkesë të subjektit dhe ka vendosur mospranimin e saj deri në këtë fazë të hetimit, duke u shprehur se do të vlerësojë dhe do të shprehet mbi riçeljen e hetimit ose jo dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore përfshirë edhe analizën financiare, gjatë bisedimeve në dhomë këshillimi, pasi të dëgjojë edhe shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore.

20. Në vijim, Komisioni ka ftuar z. Ervin Beqiri në seancë dëgjimore në datën 25.2.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, për t'u dëgjuar lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës.

21. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 1.3.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në seancë dëgjimore.

22. Me fillimin e seancës, subjekti i rivlerësimit i paraqiti dy kërkesa trupit gjykues, duke kërkuar:

“1. Kryerjen e një analize të re financiare në kuadër të hetimit administrativ në kriterin e pasurisë.

2. Konstatimin e nivelit të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe hapjen e hetimit administrativ për të tri kriteret e rivlerësimit.”

23. Trupi gjykues ndërpreu seancën dhe u tërhoq në dhomë këshillimi për të vlerësuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të saj vendosi të administrojë të dy kërkesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, t'i diskutojë dhe shqyrtojë gjatë procesit të diskutimeve për vendimmarrjen, të cilën e bëri prezente në seancë.

24. Në vijim, trupi gjykues zhvilloi seancën dëgjimore. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi rihapjen e hetimit në lidhje me kriterin e pasurisë dhe konstatimin e Komisionit se është bërë deklarim i saktë dhe në përputhje me ligjin e të gjitha pasurive dhe të burimit të krijimit të tyre si dhe çeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera, të vlerësimit profesional dhe të kontrollit të figurës.

25. Në seancën publike të datës 3.3.2022, trupi gjykues njoftoi se pas diskutimeve në dhomë këshillimi dy kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe administruar nga trupi gjykues në seancën e datës 1.3.2022, nuk u pranuan, duke shpallur në vijim vendimin përfundimtar për rivlerësimin e subjektit Ervin Beqiri.

Subjekti nuk ishte prezent në këtë seancë dëgjimore, megjithëse kishte marrë dijeni për zhvillimin e saj nga seanca e mëparshme.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT KALIMTAR I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

26. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

27. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin¹ e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit Ervin Beqiri, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për këtë subjekt, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

28. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

29. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë si më poshtë.

30. Pasuria apartament banimi, me sipërfaqe të përgjithshme 104.18 m² dhe me sipërfaqe të brendshme 92.42 m², të ndodhur në Tiranë, Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, pallati “****”, shkalla ***, apartamenti ***, i paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë, blerë me Kontratën e Sipërmarrjes së datës 26.1.2013, me vlerë 90,000 (nëntëdhjetë mijë) euro. Pagarar shuma 87,000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) euro, detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë vlera 3,000 (tre mijë) euro.

31. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) kursimet personale para martesë; (ii) kursimet familjare gjatë martesës; si dhe (iii) huan pa interes të marrë nga familjarët (hua e shlyer plotësisht në vitin 2016).

32. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: rezulton se në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja gjenden 2 (dy) deklarata të interesave private (në vijim DIP) të vitit 2013, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit.

i) Referuar njëjës prej deklaratave konstatohet se në seksionin “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2013, për blerjen e një apartamenti dhe se ka paguar shumën prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro. Ndërsa, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar shumën prej 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë të marrë

¹Akti i përfundimit të kontrollit nr. *** prot., datë 10.4.2019.

hua nga babai A. B., vërtetuar nga Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2014 dhe se gjendja e detyrimit të mbetur në datën 31.12.2013, është në vlerën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë.

ii) Referuar deklaratës tjetër që i përket vitit 2013 konstatohet se, subjekti ka paraqitur shpjegime më të zgjeruara/detajuara lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe detyrimet e tij dhe të personave të lidhur dhe, konkretisht, në seksionin “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2013, për blerje apartamenti dhe se ka paguar shumën prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro, me burim nga kursimet familjare për vitin 2013, në shumën prej 1,263,000 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, nga kursimet familjare të viteve të mëparshme në shumën prej 4,822,000 (katër milionë e tetëqind e njëzetë e dy mijë) lekë dhe nga huaja e marrë nga shtetasi A. B. në shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë. Gjithashtu, ka deklaruar: (i) mbylljen e depozitës bankare në emër të shtetases Xh. B. pranë “Alpha Bank” në datën 6.3.2013, kaluar shuma në llogarinë e tij; (ii) mbyllur depozita në emër të tij në “Alpha Bank” në datën 22.7.2013 dhe shuma është kaluar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. Ndërsa, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si detyrime: (i) shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë, dhënë hua nga babai; si dhe (ii) shumën 10,000 (dhjetë mijë) euro, pa paguar shoqërisë “****” sh.p.k.

33. Në DIP-në e vitit 2014, në seksionin “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2013, për blerje apartamenti dhe se ka paguar gjithsej shumën 87,000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) euro, nga të cilat shuma 7,000 (shtatë mijë) euro është paguar për vitin 2014. Ndërsa, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar shumën 3,000 (tre mijë) euro, si detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

34. Në DIP-në e vitit 2015 dhe DIP-në e vitit 2016 shuma 3,000 (tre mijë) euro deklarohet nga subjekti si detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k..

35. Komisioni i kërkoi të evidentojë shpenzimet më të larta se 2,500 (dymijë e pesëqind) euro – që nga momenti i fillimit të detyrës, datën e kryerjes së shpenzimit, qëllimin, burimin financiar dhe mënyrën e pagesës. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se² në datën 26.1.2013 ka lidhur bashkë me bashkëshorten, si palë porositëse, Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., me palë të porositura shoqërinë “****” sh.p.k., dhe shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën gjithsej 90,000 (nëntëdhjetë mijë) euro, për një apartament banimi me sipërfaqe të përgjithshme 104.18 m² dhe me sipërfaqe të brendshme 92.42 m². Qëllimi i këtij shpenzimi ka qënë për t’u përdorur për qëllime banimi familjare. Aktualisht ky apartament nuk është regjistruar akoma në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (ASHK Tiranë). Për këtë apartament është paguar deri në këtë moment shuma gjithsej prej 87,000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) euro.

36. Rezulton se në datën 26.1.2013 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë porositur³ nga shoqëritë “Landro” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe konvencionale prej 104.18 m² dhe sipërfaqe të brendshme të ambienteve prej 92.42 m², për çmimin prej 90,000 (nëntëdhjetë mijë) euro, ndodhur në katin e *** , shkalla *** , numërtuar me nr. *** , në objektin që këto shoqëri po ndërtonin/kanë ndërtuar në “****”, Tiranë.

37. Referuar Kontratës së Sipërmarrjes, plani i pagesave për shlyerjen e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, është përcaktuar si vijon: (i) pagesa e kështit të parë është kryer para nënshkrimit të kontratës në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, jashtë zyrës noteriale; (ii) kësti i dytë

²Referojuni pyetjes nr. 9 të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni dhe përgjigjeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

³Kontratë sipërmarrjeje për apartamentin me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2013, redaktuar nga noteri publik I. B. depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës Vetting (ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së), si dhe pjesë e dokumentacionit shoqëruës që lidhet me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni.

prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro do të likuidohet në fund të muajit maj të vitit 2013; (iii) kësti i tretë prej 8,000 (tetë mijë) euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë; si dhe (iv) kësti i fundit prej 2,000 (dy mijë) euro do të likuidohet në momentin e marrjes së vërtetimit të pronësisë.

38. Lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁴ *si burim financiar për blerjen e këtij apartamenti në momentin e kryerjes së pagesës për herë të parë, në vazhdim dhe për shlyerjen e detyrimeve nga huat e marra janë: (i) kursimet e tij përpara fillimit të punës si prokuror; (ii) të ardhurat nga paga si prokuror nga viti 2009 e në vazhdim; (iii) të ardhurat nga fitimi i shumës prej 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekësh nga emisioni “***”, në *** në datën 15.11.2011; (iv) të ardhurat nga interesat bankare nga depozitat bankare që ka pasur ai dhe bashkëshortja në bankat e nivelit të dytë dhe në Bono Thesari pranë Bankës së Shqipërisë; (v) të ardhurat e përfutuara nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes Xh.B. si person fizik me NIPT ***, si vlerësuese e pasurive të paluajtshme për periudhën mars 2013 dhe në vazhdim; (vi) të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes pranë shoqërisë publike “U.-K., Tiranë” sh.a., për periudhën gusht 2009 – maj 2011; (vii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si drejtuese teknike e shoqërisë publike “U.-K.” sh.a., Librazhd, për periudhën 2.11.2009 – 22.6.2011; (viii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes Xh. B., si punonjëse pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën shkurt 2013 – mars 2013; (ix) të ardhurat nga paga e bashkëshortes të marra si inxhinierë hidroteknike pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, për periudhën tetor 2014 – maj 2015 dhe për periudhën maj 2016 e në vazhdim; (x) të ardhurat nga paga e bashkëshortes të marra si inxhinierë hidroteknike pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, për periudhën qershor 2015 – prill 2016, po paguar paga deri në nëntor të vitit 2015; (xi) të ardhurat nga paga e bashkëshortes Xh. B. si punonjëse pranë shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën qershor 2011 – dhjetor 2012; si dhe (xii) të ardhurat nga sigurimet shoqërore si përfitim për barrë lindje, etj.*

39. Lidhur me pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi dhe të ardhurat të cilat kanë shërbyer si burim në momentin e kryerjes së pagesës/pagesave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁵:

*i) Pagesa e parë është bërë në shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes të datës 26.1.2013 e vërtetuar me kontratën e sipërmarrjes, neni 3/1 të saj dhe me mandatarkëtimin nr. ***, datë 26.1.2013, të shoqërisë “****” sh.p.k. Si burim për kryerjen e kësaj pagese kanë qenë kursimet personale e familjare cash të tij deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, si dhe të një shume të marrë hua prej 5,100,000 (pesë milionë e njëqindmijë) lekësh – të marrë hua nga babai i tij, A. B., e vërtetuar nga Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2014. Kjo shumë e dhënë hua ka qenë pa interes dhe pa afat për shkak të marrëdhënieve shumë të mira familjare me njëri-tjetrin. Aktualisht kjo hua është shlyer plotësisht deri në vitin 2016.*

*ii) Pagesa e dytë është kryer në shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro ose 4,215,000 (katër milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë nëpërmjet “Alpha Bank”, dega e Tiranës, në datën 22.7.2013, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo pagesë vërtetohet me mandat urdhërpaguese të “Alpha Bank”, dega Tiranë, të datës 22.7.2013. Si burim për kryerjen e kësaj pagese ka shërbyer tërheqja e të gjithë shumës të depozituar në “Alpha Bank” në emër të tij. Në këtë datë është bërë dhe mbyllja e llogarisë në këtë bankë. Për krijimin e kësaj depozite bankare ka shërbyer bashkimi i të gjitha depozitave bankare në “Alpha Bank”, në emër të tij dhe të bashkëshortes, Xh. B., si dhe nga depozitimi në datën 6.3.2013 në llogarinë e bashkëshortes në “Alpha Bank”, të një shume prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, të marrë hua babait të tij, A. B., dhe të shlyer tërësisht gjatë vitit 2013 me kursimet e këtij viti.*

⁴Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 1 (pyetja nr. 9).

⁵Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 1 (pyetja nr. 9).

iii) *Pagesa e tretë është bërë në shumën prej 7,000 (shtatë mijë) euro. Kjo pagesë është bërë cash në Zyrën e Financës të shoqërisë “***” sh.p.k., e vërtetuar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.8.2014, të kësaj shoqërie. Si burim për kryerjen e kësaj pagese ka shërbyer tërheqja e shumës prej 1,000,000 (një milion) lekësh nga Banka e Shqipërisë në datën 10.4.2014 të depozituara në bono thesari në emër të bashkëshortes, Xh. B.*

40. Analiza e të ardhurave, të cilat janë deklaruar si burim për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi dhe verifikimi i mënyrës së kryerjes së pagesave.

a) *Pagesa e kështit të parë në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro*

41. Shoqëria “***”⁶ sh.p.k., informon se në datën 25.1.2013 subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë zyrave të saj shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, e cila pas nënshkrimit të Kontratës së Sipërmarrjes (datë 26.1.2013), në datën 29.1.2013 është depozituar në llogarinë e shoqërisë pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me përshkrimin “këst apartamenti për Ervin Beqiri sipas Kontratës nr. *** rep., nr. *** kol”, duke vënë në dispozicion: (i) kopje të mandatpagesës nr. ***, datë 25.1.2013, për pagesën e kryer nga subjekti në shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro; si dhe (ii) kopje të mandatit bankar, datë 29.1.2013, në Bankën Kombëtare Tregtare, për depozitim të kësaj shume në llogari të shoqërisë.

42. Lidhur me të ardhurat, të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së kështit të parë në shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, duket se subjekti ka deklaruar si burim: (i) kursimet e mëparshme personale dhe familjare në gjendje *cash*; si dhe (ii) shumën prej 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë të marrë hua nga babai.

43. Nga verifikimi i deklaratave të interesave private/periodike vjetore të depozituara, ndër vite, nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se ka kryer deklarime lidhur me pasurinë e llojit likuiditete *cash*, si vijon:

i) Në DIP-në para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 7.12.2009), subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën 900,000 (nëntëqind mijë) lekë – se zotëron 80% pjesë të kësaj pasurie, me burim krijimi kursimet familjare dhe personale nga ushtrimi i profesionit të avokatit.

ii) Në DIP-në e vitit 2009 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë dhe se zotëron 100% pjesë të kësaj pasurie.

iii) Në DIP-në e vitit 2010 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, shtuar shumën me 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë, me burim kursimet vjetore të tij dhe të bashkëshortes. Gjendja *cash* prej 1,000,000 (një milion) lekësh – pjesa që zotëron 80%.

iv) Në DIP-në e vitit 2011 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, shtuar nga kursimet familjare shumën prej 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh.

v) Në DIP-në e vitit 2012 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, shtuar nga kursimet familjare dhe nga mbyllja e depozitës në “ProCredit Bank” shumën 1,930,000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë.

44. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni, lidhur me deklarimin e likuiditeteve gjendje *cash*, duke i kërkuar të paraqesë në mënyrë kronologjike të gjitha shtesat dhe pakësimet ndër vite, që nga deklarimi fillestar dhe deri në fund të vitit 2012, si dhe gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, ka deklaruar se⁷ *para fillimit të detyrës në tetor të vitit 2009 gjendja cash ka qenë në vlerën 720,000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekë.*

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 27.10.2021, e shoqërisë “***” sh.p.k., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.10.2021.

⁷Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 (pyetja nr. 2).

Në datën 31.12.2009 gjendja cash në banesë ka qenë në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë, duke pësuar një pakësim në shumën prej 320,000 (treqind e njëzet mijë) lekë, sepse pjesa tjetër dhe gjendja cash në momentin e deklarimit fillestar ka kaluar si depozitë në “ProCredit Bank”.

Në datën 31.12.2010 gjendja cash në banesë ka qenë në vlerën 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekësh dhe shtesa ka qenë në masën prej rreth 900,000 (nëntëqind mijë) lekësh. Kjo mospërputhje deklarimi me atë që është deklaruar në DIP-në e vitit 2010, ku është deklaruar gjendja cash në vlerën prej 1,000,000 (një milion) lekësh, ka ndodhur për shkak të gabimit material që është bërë prej tij në deklarimin e këtij viti kur ka deklaruar si depozitë me afat 1-vjeçar në ‘Alpha Bank’, në emër të bashkëshortes, Xh. B., në shumën prej 1,017,822 (një milion e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e dy) lekësh, kur në fakt deri në datën 31.12.2010 kjo depozitë ka qenë në shumën 710,648 (shtatëqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë dhe ka mbaruar si afat kontrate depozite në datën 21.1.2011, datë kur është ripërtërirë. Për këtë gabim, ka kaluar kontroll të plotë dhe ka dhënë shpjegime me procesverbalin e datës 17.2.2012 përpara ILDKPKI-së.

*Në datën 31.12.2011, shtesa në gjendjen cash ka qenë 0 (zero) lekë dhe gjendja cash ka qenë 925,000 (nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, duke pësuar pakësim nga deklarimi i mëparshëm. Kjo mospërputhje deklarimi me atë që është deklaruar në DIP-në e vitit 2011, ku është deklaruar gjendja cash në vlerën prej 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh është bërë për shkak të një gabimi material, për shkak se në deklarimin e vitit 2011 në momentin e deklarimit është llogaritur gabimisht si gjendje cash në banesë edhe vlera 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë të fituara prej tij nga emisioni “***”, në televizionin ***, shumë e cila pavarësisht se është fituar në datën 15.11.2011, është kaluar në llogarinë e tij bankare pranë ‘Raiffeisen Bank’ në datën 26.1.2012, pra, nuk është një e ardhur që është fituar për vitin 2011, po për vitin 2012.*

*Në datën 31.12.2012, shtesa në gjendjen cash ka qenë në vlerën prej 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekësh cash dhe gjendja cash ka qenë në vlerën totale prej 1,930,000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekësh. Këtu duhet patur parasysh fakti se është llogaritur/shtuar dhe shuma 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë fituar nga emisioni ‘***’.*

Në datën 31.12.2013 nuk ka pasur gjendje cash në banesë, pasi e gjithë shuma totale cash e viteve të mëparshme dhe kursimet e vitit 2013 janë përdorur të gjitha për blerjen e apartamentit në datën 26.1.2013.

45. Bazuar në pikën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”⁸, i ndryshuar, në përputhje me kërkesat e formularëve të deklarimit të pasurive në seksionin “deklarimi/ndryshimi i interesave private – pasuritë e luajtshme/pasuritë e paluajtshme”, si dhe nisur nga pasaktësitë dhe mospërputhjet e konstatuara në deklarimet e subjektit për shtesat/pakësimet dhe gjendjet e likuiditeteve *cash*, për periudhën nga vitit 2009 – 2012, Komisioni paraprakisht vlerëson se ecuria e likuiditeteve *cash* (shtesa/pakësime/gjendje fund viti), për këtë periudhë, ka qenë si vijon: (i) në momentin e fillimit të detyrës (datë 12.10.2009), subjekti duket se ka disponuar gjendjen *cash* në shumën 720,000 (shtatëqind e njëzetë mijë) lekë; (ii) në datën 31.12.2009, duket se ka disponuar gjendjen *cash* në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë. Pakësuar nga deklarimi i mëparshëm shuma prej 320,000 (treqind e njëzetë mijë) lekësh; (iii) në datën 31.12.2010, duket se ka disponuar gjendjen *cash* në shumën 1,000,000 (një milion) lekë. Shtuar nga deklarimi i mëparshëm shuma prej 600,000 (gjashtëqind mijë) lekësh; (iv) në datën 31.12.2011, duket se ka disponuar gjendjen *cash* në shumën prej 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë. Shtuar nga deklarimi i mëparshëm shuma prej 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë; (v) në datën 31.12.2012, duket se ka disponuar

⁸Sipas kësaj dispozite, subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rjedhëse, në depozitë, në Bono Thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, si dhe burimin e krijimit të tyre.

gjendjen *cash* në shumën prej 1,930,000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekësh. Shtuar nga deklarimi i mëparshëm shuma prej 330,000 (treqind e tridhjetë mijë) lekësh.

Si rrjedhim, do të pasqyrohen si të tilla shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash* në analizën financiare paraprake të kryer nga Komisioni. Shuma prej 1,930,000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekësh, e deklaruar nga subjekti si gjendje *cash* e disponuar në fund të vitit 2012, është deklaruar si një nga burimet që ka shërbyer për likuidimin e kështit të parë në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi.

46. Pasi u pyet nga Komisioni, specifikisht lidhur me shumën prej 900,000 (nëntëqind mijë) lekësh të deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar duke sqaruar se⁹ 20% e kësaj shume – vlera prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë është gjendje *cash* e babait A. B., e krijuar nga kursimet familjare të tij. Kjo shumë të hollash nuk i është dhënë hua ose dhuratë dhe nuk ka shërbyer si burim krijimi i ndonjë pasurie të tij. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi të shumës prej 720,000 (shtatëqind e njëzetë mijë) lekësh gjendje *cash* në momentin para fillimit të detyrës – krahas të ardhurave të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara nga bursa në Shkollën e Magjistraturës dhe ato të përfituara në bazë të një vendimi gjyqësor¹⁰, i cili ka marrë formë të prerë, vërtetuar me praktikën përmbartimore të ekzekutimit të këtij vendimi¹¹.

47. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e mundësisë së krijimit të likuiditeteve gjendje *cash* të deklaruara nga subjekti, si dhe të pasurive të tjera dhe shpenzimeve të deklaruara apo të evidentuara nga Komisioni, u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën para fillimit të detyrës, periudhën nga data e fillimit të detyrës deri në datën 31.12.2009 dhe në vijim për vitet 2010 – 2012, të pasqyruar në tabelën vijuese.

Analiza financiare/periudha (vlerat në lekë)	deri 12.10.2009	13.10.2009-31.12.2009	2010	2011	2012
A) Pasuri	988 644	189 774	1 373 571	2 174 596	897 583
Automjet, tip “Mercedes-Benz”, blerë në datën 2.3.2012.					419 160
Ndryshim likuiditeti	988 644	189 774	1 373 571	2 174 596	478 423
B) Detyrime	0	0	0	0	0
C) Pasuri <i>neto</i> (A-B)	988 644	189 774	1 373 571	2 174 596	897 583
D) Të ardhura	2 286 658	156 366	1 801 412	1 834 822	2 337 846
Të ardhura të subjektit nga paga/puna, deri më 12.10.2009	2 261 890				
Të ardhura nga paga, subjekti		147 759	909 047	945 303	921 412
Të ardhura nga paga të bashkëshortes, para martesë			123 420		
Të ardhura nga paga, bashkëshortja			693 331	804 046	560 591
Të ardhurat e fituara nga loja “****”, ****					675 000
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	24 768	8 607	75 614	85 473	180 843
E) Shpenzime	691 771	31 067	434 731	552 174	446 416
Shpenzime minimale jetike	691 771	31 067	273 240	273 240	282 048

⁹Referojuni përgjigjeve të pyetjes nr. 1(i) dhe 1(ii), të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

¹⁰Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 27.6.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹¹Praktika përmbartimore e depozituar nga subjekti, e përbërë nga kopje të dokumenteve, si vijon: (i) vendim nr. *** prot., datë 5.12.2007, i Zyrës Përmbartimore Tiranë, për pushimin e “Urdhrit të ekzekutimit”, të ekzekutuar tërësisht; (ii) shkresa nr. ***, datë 26.11.2007, e Zyrës Përmbartimore Tiranë; (iii) shkresa nr. *** prot., datë 11.8.2006, “Garanci Bankare”, e “Raiffeisen Bank”; si dhe (iv) mandat bankar i datës 27.11.2007, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* nga llogaria e Zyrës Përmbartimore Tiranë në Raiffeisen Bank, shumën 626,000 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë.

Shpenzime për udhëtimet jashtë vendit			152 691	23 084	115 968
Shpenzime për udhëtimin në vendin e punës në Lezhë, subjekti			8 800	48 400	48 400
Shpenzime avokatie në Itali				207 450	
Balanca e fondeve (D-C-E)	606 243	-64 475	-6 890	-891 948	993 7

48. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (likuiditeteve *cash* + bankë) dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara nga Komisioni, për periudhën nga data e fillimit të detyrës deri më 31.12.2009, si dhe për vitin 2010 dhe 2011 [totali i balancës negative të fondeve në vlerën 963,313 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë].

49. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, barrën e provës për të dhënë argumentet dhe provuar të kundërtën e rezultatit të analizës financiare.

50. Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon sa vijon:

a) Lidhur me të ardhurat e përfituara para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit kërkon që të përfshihen në analizë financiare të ardhurat ligjore nga puna si avokat në vlerën 15,300 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind) lekë, duke vënë në dispozicion dokumentacion¹² provues.

Trupi gjykues, pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe dokumentet në funksion, i ka pranuar shpjegimet e subjektit duke reflektuar në analizën financiare këtë shumë.

b) Lidhur me të ardhurat e përfituara, për periudhën 13.10.2009 – 31.12.2009, subjekti pretendon se vlera prej 147,759 (njëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, me burim nga paga, nuk është në përputhje me shumën e të ardhurave të përcaktuara në dokumentin e datës 16.10.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pasqyrohet vlera prej 211,946 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzetë e gjashtë) lekësh. Subjekti argumenton se nga Komisioni nuk është llogaritur paga e muajit dhjetor të vitit 2009, në vlerën 85,006.97 (tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtë presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

Në vijim të pretendime të subjektit, Trupi gjykues konstaton se përlllogaritja e të ardhurave, për periudhën 13.10.2009 – 31.12.2009, është kryer sipas kreditimit të pagës në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” dhe paga për muajin dhjetor është kredituar në muajin janar të vitit 2010 në llogarinë e pagës së subjektit, prandaj ky pretendim nuk është marrë në konsideratë.

c) Lidhur me të ardhurat e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit shpjegon se vlera totale prej 909.047 (nëntëqind e nëntë mijë e dyzetë e shtatë) lekë e përcaktuar në analizën financiare të Komisionit nuk është në përputhje me shumën e të ardhurave që përcaktohet në dokumentin e datës 16.10.2016, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën janar - tetor 2010, në vlerën 744,094 (shtatëqind e dyzetë e katër mijë e nëntëdhjetë e katër) lekë, si dhe me vërtetimin e pagesave nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për muajt nëntor - dhjetor 2010, në vlerën 176,688 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

Në vijim të pretendimit të subjektit, Trupi gjykues konstaton se përlllogaritja e të ardhurave për vitin 2010 është kryer sipas kreditimit të pagës në llogarinë e subjektit në “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank” dhe shuma e të ardhurave të pagës për vitin 2010 përputhet me shumën e kreditimeve për vitin 2010 në llogarinë bankare dhe me shumën e të ardhurave të paraqitura në rezultatet e hetimit. Ky pretendim vjen pasi subjekti rivlerësimit në dokumentin e paraqitur “vërtetimin page” nga institucioni përfshin pagën, për periudhën janar - dhjetor 2010, ndërsa

¹² Shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2021

përlllogaritja e kryer nga Komisioni përfshin kreditimet në bankë, të ardhurat që ka përfituar realisht atë vit kalendarik, prandaj ky pretendim nuk është marrë në konsideratë.

ç) Për vitin 2010, meqenëse është viti në të cilin ka lidhur martesë ligjore me shtetasen Xh. M. (konkretisht në mars të vitit 2010), subjekti rivlerësimi kërkon që të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat e siguruara përpara martese nga ana e bashkëshortes të cilat kanë shtuar gjendjen *cash* në banesë dhe kanë shërbyer si burim të ardhurash për krijimin e llogarisë bankare në emër të saj dhe për krijimin e depozitës në “Alpha Bank”, në prill të vitit 2010, vetëm një muaj pas martesës ligjore. Subjekti rivlerësimi ka paraqitur dokumentacion provues për të ardhurat (statement bankar, vërtetime nga punëdhënësi, etj.).

Lidhur me pretendimin e subjektit për të llogaritur në analizën financiare të vitit 2010 të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja para martese në vitet 2008 - 2009 në shumën totale prej 530,322 (pesëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzet e dy) lekësh, shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve në “Alpha Bank”, Trupi gjykues konstaton se depozita bankare në këtë bankë është çelur me derdhje *cash* prej bashkëshortes në shumës 400,000 (katërqind mijë) lekë, një muaj pas martesës me subjektin e rivlerësimi dhe është shtuar në muajin tetor me shumën 300,000 (treqind mijë) lekë.

Komisioni, në vlerësim të shpjegimet të subjektit të rivlerësimi dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij sa më sipër, pranon arsyetimin duke marrë në konsideratë të ardhurat për krijimin e depozitës në datën 21.4.2010 në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë, si të ardhura të ligjshme të bashkëshortes të krijuara nga puna e saj dhe duke i përfshirë në analizë financiare për çeljen e depozitës në “Alpha Bank” në emrin e saj.

Në vijim të kësaj logjike, situata negative financiare e vitit 2010 ndryshon, duke rezultuar me balancë pozitive [nga -6,890 (gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë, bëhet + 322,000 (treqind e njëzet e dy mijë) lekë].

Trupi gjykues nuk ka pranuar kërkesën e subjektit për përfshirjen e shumës që rezulton si balancë pozitive e këtij viti, si gjendje *cash* në fund të vitit dhe e transferuar në vitin pasardhës, duke reflektuar në analizë financiare gjendjen *cash* në vitin 2010, sipas DPV-së të bërë më herët nga subjekti rivlerësimi në DPV- në përkatëse në shumën 1,000,000 (një milion) lekë.

d) Lidhur me analizën financiare të vitit 2011, subjekti i rivlerësimi ka shpjeguar në prapësimet e tij sa vijon: *“Për analizën financiare për vitin 2011 unë kam rezultuar me balancë negative në vlerën 891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e dyzet e tetë) lekësh. Në analizën financiare të këtij viti konstatoj se gabimisht më është përlllogaritur se gjendja ime cash në banesë për këtë vit ka qenë në vlerën 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe se shtesa e gjendjes cash për këtë vit ka qenë në vlerën 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë. Konstatoj se në arritjen e këtij konkluzioni nga Komisioni është përlllogaritur dy herë si për vitin 2011 dhe për vitin 2012 të ardhurat e përfituara nga ana ime në emisionin ‘***’ të televizionit ***, në vlerën prej 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekësh, dhe që është pasqyruar gabimisht në deklaratën periodike të vitit 2011. Siç e kam sqaruar dhe në deklaratimet e mia përpara ILDKPKI-së në vitin 2016, në deklaratën Vetting dhe në përgjigjet e mia në pyetësorin nr. 2, kjo vlerë pavarësisht se është fituar në këtë program në datën 15.11.2011, është kaluar në llogarinë bankare në ‘Raiffeisen Bank’ të Ervin Beqirit në datën 26.1.2012, pra, nuk është një e ardhur që është fituar për vitin 2011, po për vitin 2012. Pra, shtesa në gjendjen cash për vitin 2011 ka qenë 0 (zero) lekë dhe gjendja cash ka qenë në vlerën 925,000 (nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë. Theksoj se shuma 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë që unë kam deklaruar në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2011 ka përfshirë gabimisht dhe shumën 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të cilat janë kaluar në llogarinë time bankare në datën 27.1.2012. Kërkoj nga ana e Komisionit që në analizën e re financiare të saj të zbresë si mundësi kursimi të gjendjes cash këtë shumë për vitin 2011”.*

Në vijim, Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin përkatës, nga ku rezulton se ka deklaruar gjendjen *cash* të vitit 2011 në shumën prej 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh, por se ka paraqitur si burim të ardhurat e përfituara nga emisioni televiziv “***”.

Duke vlerësuar shpjegimet e subjektit në harmoni me dokumentacionin provues dhe gjendjen e fakteve, Trupi gjykues pranon se deklarimi i bërë në vitin 2011 është një pasaktësi e paqëllimshme nga subjekti rivlerësimit dhe pranon shpjegimet e tij, duke pasqyruar vlerën 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë si shtesë e gjendjes *cash* në vitin 2012.

dh) Lidhur me shpenzimet për udhëtime në vendin e punës, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, subjekti kërkon që të bëhet një zbritje në vlerën 4,400 (katër mijë e katërqind) lekë, pasi për muajin gusht nuk ka pasur shpenzime, si muaj pushimi zyrtar. Njëkohësisht, subjekti shpjegon se për vitin 2011 ka udhëtuar me automjetet e kolegëve.

Trupi gjykues ka pranuar këtë kërkesë të subjektit, duke marrë në konsideratë dhe rillojaritur në analizën financiare shpenzimet e udhëtimeve për në vendin e punës sipas deklarimeve të tij.

e) Mbi interesat e përfituara nga depozitat bankare në vitin 2011, subjekti sqaron se vlera e përfituar është 102,600 (njëqind e dy mijë e gjashtëqind) lekë dhe jo 85,473 (tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) lekë. Subjekti shpjegon se vlera prej 102,600 (njëqind e dy mijë e gjashtëqind) lekësh përfshin: 45,000 (dyzet e pesë mijë) lekë nga interesat në “ProCredit Bank” të llogarisë së subjektit të rivlerësimit; një shumë prej 32,600 (tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind) lekësh nga interesat e përfituara nga depozita të “Alfa Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit; si dhe shumën prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) lekësh të përfituar nga interesat e depozitës të shtetases Xh. B. në “Alfa Bank”.

Trupi gjykues konstaton se qëndrimet e subjektit nuk shoqërohen me ndonjë dokumentacion provues dhe se të llogaritura sipas dokumentacionit të administruar nga Komisioni shuma mbetet e njëjtë, duke mos reflektuar ndryshim në analizën financiare.

ë) Për sa i përket interesave të përfituara nga depozitat bankare në vitin 2012, subjekti sqaron se duhet të llogariten në vlerën 244,489 (dyqind e dyzet e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë dhe jo në vlerën 180,843 (njëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë (sipas analizës së Komisionit). Vlera 244,489 (dyqind e dyzet e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë)lekë përfshin, konkretisht: shumën 55,356 (pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë nga interesat nga Banka e Shqipërisë; shumën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë nga interesat në “ProCredit Bank” të llogarisë së subjektit të rivlerësimit; shumën 48,454 (dyzet e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë nga interesat në “Alfa Bank” të llogarisë së subjektit të rivlerësimit; si dhe shumën 80,679 (tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë nga depozita bankare e shtetases Xh. B. në “Alfa Bank”.

Trupi gjykues, pasi vlerësoi dokumentacionin e administruar, vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi subjekti rivlerësimit llogarit vlerat teorike, ndërsa Komisioni ka marrë në konsideratë vlerat e arkëtuara në llogaritë përkatëse të interesit për vitin 2012. Trupi gjykues konstaton se subjekti ka pretenduar interesa si Bono Thesari të përfituara në vitin 2012, kur faktikisht një pjesë e tyre janë maturuar në vitin 2013, periudhë kur është përfituar edhe interesi. Në përfundim, shuma mbetet e njëjtë, duke mos reflektuar ndryshim në analizën financiare.

51. Në vijim, analiza financiare e rishikuar, për periudhën 13.10.2009 – 31.12.2012, rezulton me pamundësi në krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vlerën 1,930,000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë dhe përdorur në vitin 2013, në vlerën totale prej -277,423 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzetetre) lekësh. Në përfundim, trupi gjykues ka përfshirë në analizën financiare, si burim për krijimin e pasurisë, të ardhura nga

gjendja *cash* në vlerën 1,652,577 lekë (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë).

52. Në dy DIP-të e vitit 2013 të dorëzuara në ILDKPKI – në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë të marrë hua nga babai A. B., konfirmuar me deklaratën noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2014 dhe se gjendja e detyrimit të mbetur në fund të vitit 2013 ka qenë në shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë.

53. Referuar dokumentit noterial¹³ të datës 18.3.2014, z. A. B. ka deklaruar se i ka dhënë në muajin janar të vitit 2013, djalit Ervin Beqiri një hua në shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë për blerjen e një pasurie të paluajtshme, të cilën ia ka dhënë pa afat kohor kthimi.

54. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni¹⁴ nëse ka marrë hua nga persona apo shoqëri private, duke i kërkuar të deklarojë shumën, datën, marrëdhënien me huadhënësin, kushtet dhe gjendjen e shlyerjes, ka deklaruar se¹⁵ ka marrë dy hua nga babai A. B., si vijon:

i) Shuma e parë e marrë hua në janar të vitit 2013 në vlerën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë pa interes dhe pa afat shlyerje, e cila ka shërbyer për të bërë pagesën e këstit të parë për kontratën e sipërmarrjes. Gjithashtu, deklaruar se kjo marrëdhënie juridike huaje është me dokument me shkrim dhe se shuma e huas është likuiduar tërësisht në fund të vitit 2016.

ii) Shuma 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë marrë në datën 6.3.2013, e cila ka shërbyer për pagimin e këstit të dytë për kontratën e sipërmarrjes së apartamentit. Kjo hua e marrë nga babai ka qenë pa dokument/kontratë me shkrim, pa interes dhe pa afat. Aktualisht kjo shumë e marrë hua është shlyer prej tij brenda vitit 2013, me kursimet e këtij viti.

55. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi i shumave të marra hua kanë shërbyer: (i) kursimet e babait dhe nënës, ndër vite; (ii) shumat që babai ka marrë hua nga vajzat e tij (motrat e subjektit), për të plotësuar këto shuma; si dhe, (iii) marrja hua prej babait të tij e dy shumave nga të afërmit e tij: (a) shumën 1,000,000 (një milion) lekë nga e motra, shtetasja M. M. (B.); dhe (b) shumën 800,000 (tetëqind mijë) lekë nga shtetasit Th. P. dhe E. P..

56. Lidhur me të ardhurat e babait të tij, që kanë shërbyer për krijimin e një pjese të shumës për huan e pretenduar, subjekti ka deklaruar se kanë qenë: (i) të ardhurat nga punësimi i tij si oficer aktiv ushtrie¹⁶ për periudhën 1.8.1963 – 29.2.1996; (ii) të ardhurat nga pagesa kalimtare si ushtarak në rezervë për periudhën mars 1996 – shkurt 1998; (iii) të ardhurat nga puna si inxhinier elektronik pranë shoqërisë “****” sh.a.¹⁷, për periudhën korrik 1998 – shtator 2006, duke sqaruar se për periudhën shtator 2004 – gusht 2006 është paguar me pagesë të plotë, pavarësisht largimit fizik nga puna për shkak të reformës në “****”; si dhe (iv) të ardhurat e përfutuara nga pensioni i pleqërisë dhe pensioni suplementar shtetëror i ushtrisë¹⁸, dalë në pension më 1.9.2006.

57. Lidhur me të ardhurat e nënës së tij, që kanë shërbyer për krijimin e një pjese të shumës për huan e pretenduar, subjekti ka deklaruar se kanë qenë: (i) të ardhurat nga puna si oficere aktive në ushtri¹⁹ për periudhën 1.9.1968 – 15.10.1992; (ii) të ardhurat nga trajtimi me pagesë

¹³Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2014, redaktuar nga noteri publik Dh. Q.

¹⁴Pyetësori nr. 1.

¹⁵Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 1 (pyetja nr. 19).

¹⁶Ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 15.9.2006, të lëshuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; (ii) vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për periudhën 1 janar 1994 – 31 korrik 1994; si dhe (iii) vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* për periudhën 1 gusht 1994 – 29 shkurt 1998.

¹⁷Ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 15.3.2016, lëshuar nga shoqëria “****” sh.a.; (ii) vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, për periudhën korrik 1998 – 16 nëntor 2001; (iii) vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, për periudhën 15 nëntor 2001 – gusht 2004; si dhe (iv) vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*, për periudhën 1 shtator 2004 – 1 shtator 2006.

¹⁸Ka depozituar si dokumentacion provues, vërtetimin nr. *** prot., datë 20.11.2018, lëshuar nga DRSSH-ja Tiranë dhe disa formuluarë/modular për llogaritjen e pensionit.

¹⁹Ka depozituar si provë, dokumentin “modular për efekt pensioni, vjetërsie shërbimi invaliditeti ose familjar” me nr. *** prot., datë 8.7.2005, lëshuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.

kalimtare si ushtarake në rezervë²⁰ për periudhën tetor 1992 – dhjetor 1995; (iii) të ardhurat e përfituara nga pensioni i parakohshëm si ish-ushtarake për periudhën nga 1.1.1999 – 28.6.2007; si dhe (iv) të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë dhe pensioni suplementar shtetëror i ushtrisë, nga data e daljes 1.7.2007 dhe në vazhdim²¹.

58. Subjekti ka deklaruar se prindërit e tij kanë ushtruar aktivitet privat tregtar ambulant në qytetin e Fierit që nga vitet 1992 - 1993 deri në fund të vitit 2001, kur kanë ardhur familjarisht në Tiranë dhe se ky aktivitet tregtar ka qenë burim i konsiderueshëm i të ardhurave familjare gjatë kësaj periudhe kohore. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) dy deklarata noteriale²² – në referim të cilave, krahas prindërve të subjektit edhe shtetas të ndryshëm konfirmojnë faktin se ata kanë ushtruar aktivitetin si shitës ambulant në qytetin e Fierit; si dhe (ii) shkresën “kthim përgjigje” nga Bashkia Fier²³, nëpërmjet së cilës janë informuar prindërit e subjektit se sistemi *TAIS* (sistemi i administrimit të taksave dhe tarifave vendore), në të cilin regjistrohen subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi në Bashkinë Fier është në funksion nga viti 2016 dhe përfshinë të dhëna nga ky vit, duke sqaruar se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka arkivë dhe nuk ka regjistër ku të dokumentohen pagesat e taksave për vitet që janë kërkuar, pasi taksat kanë filluar të paguhen në Bashkinë Fier me miratimin e ligjit nr. 9632 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

59. Në vijim, subjekti ka deklaruar se si burim të ardhurash i motrave të tij, A. dhe F. B., të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhënë hua babait, kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga punësimi i motrës A. B., si mësuese në shkollën e mesme “Hoteleri –Turizëm”, Tiranë, për periudhën nga muaji mars i vitit 2000 dhe në vazhdim²⁴; (ii) të ardhurat në shumën 675,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë të përfituara nga e motra A. B., në datën 26.1.2012, si fituese në emisionin “****”, në ***; (iii) të ardhurat nga punësimi i motrës A. B., për periudhat korrik 2002 – shtator 2002, korrik 2003 – shtator 2003, korrik 2005 – shtator 2005, pranë shoqërisë “*****” sh.p.k.²⁵; (iv) të ardhura të tjera të përfituara prej së motrës A. B., nga Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Profesionale²⁶ si bashkëpunëtore e jashtme nga viti 2007 dhe në vazhdim; (v) të ardhurat në shumën 155,814 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë) lekë nga punësimi i të motrës F. B., në shoqërinë “*****” sh.p.k.²⁷, për periudhën 5.2.2009 – 25.6.2009; si dhe (vi) të ardhura nga punësimi i të motrës F. B., nga punësimi si specialiste pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Tiranë²⁸, për periudhën nga muaji korrik i vitit 2009 dhe në vazhdim.

60. Lidhur me marrëdhëniet e pretenduara të huamarrjes së babait të tij gjatë vitit 2013, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 25.1.2013 (shkresë e thjeshtë), sipas të cilës shtetasit Th. P. dhe E. P. deklarojnë se i kanë dhënë hua shumën 800,000 (tetëqind mijë) lekë shtetasit A. B. nga kursimet e tyre familjare, me qëllim për ta ndihmuar djalin e tij, Ervin Beqiri, për të blerë apartament në qytetin e Tiranës, shumë e cila është pranuar se është marrë nga shtetasi A. B.. Në këtë deklaratë është përcaktuar se kjo shumë është dhënë hua pa interes dhe se do të kthehet brenda vitit 2016. Ndërsa, nëpërmjet dokumentit noterial²⁹ të datës 12.3.2020, krahas deklaratës se i kanë dhënë në datën 25.1.2013 shumën 800,000 (tetëqind mijë) lekë A. B., shtetasit Th. dhe E. P. kanë deklaruar se ky shtetas e ka shlyer plotësisht këtë shumë gjatë vitit 2016.

²⁰Ka depozituar si provë, dokumentin vërtetim nr. *** prot., datë 27.9.2012, “Për pagën referuese për periudhën e trajtimit financiar të ushtarakëve sipas VKM-së nr. 225, datë 29.5.1992, dhe VKM-së nr. 07, datë 10.1.1996”.

²¹Ka depozituar si provë, dokumentin vërtetim nr. *** prot., datë 13.2.2019, nga DRSSH-ja Tiranë.

²²Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2020, redaktuar nga noteri publik A. H. dhe deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.2020, redaktuar nga noteri publik A. Ç..

²³Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2020.

²⁴Ka depozituar si provë, vërtetimin nr. *** prot., datë 11.2.2020, të ISSH-së.

²⁵Ka depozituar si provë, vërtetimin nr. *** prot., datë 11.2.2020, të ISSH-së.

²⁶Në mbështetje të deklarimeve të tij, ka depozituar dokumentin “nxjerrje llogarie nga ‘Raiffeisen Bank’”.

²⁷Ka depozituar vërtetimin e datës 10.3.2020, të shoqërisë “*****” sh.p.k.

²⁸Ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 10.3.2020.

²⁹Dokumentin, deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2020, redaktuar nga noteri publik P. B., depozituar nga subjekti, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1.

61. Gjithashtu, subjekti ka depozituar deklaratën e datës 22.1.2013 (shkresë e thjeshtë), sipas të cilës shtetasja M. M., deklaroi se i ka dhënë vëllait të saj, A. B., hua shumë 1,000,000 (një milion) lekë, nga kursimet e saj personale, me qëllim për ta ndihmuar djalin e tij (nipin e saj), Ervin Beqiri, për të blerë një apartament në qytetin e Tiranës, shumë e cila është pranuar se është marrë nga shtetasi A. B.. Në këtë deklaratë është përcaktuar se kjo shumë e dhënë hua do të kthehet në çdo kohë që huamarrësi do të ketë mundësi. Nëpërmjet dokumentit noterial³⁰ të datës 12.3.2020, krahas deklaramentit se i ka dhënë në datën 22.1.2013 shumë 1,000,000 (një milion) lekë A. B.t, shtetasja M. M. ka deklaruar se kjo shumë i është kthyer gradualisht deri në vitin 2016.

62. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur më parë nga ILDKPKI-ja, ndër të tjera, ka deklaruar se³¹ shuma 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro është plotësuar nga huaja që i ka marrë prindërve të tij, një pjesë nga gjendja *cash* që ka pasur dhe një pjesë nga një hua që i ka marrë motrave, të cilën e ka shlyer po brenda vitit 2013.

63. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur sërish nga Komisioni³² mbi burimin e të ardhurave të babait të tij, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas në shumë 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë në janar të vitit 2013, si dhe për burimin e të ardhurave të shumës tjetër prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, pretenduar si e marrë hua nga babai gjatë vitit 2013, ka referuar edhe një herë burimet e deklaruara në përgjigje të pyetësorit nr. 1 (përgjigjja e pyetjes nr. 19), por duke deklaruar edhe disa burime shtesë, si: (i) shumë 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë të përfituar nga shitja e apartamentit të prindërve në Fier³³ në vitin 2000; (ii) të ardhurat e përfituara prej motrës A. B., nga honoraret e punës së kryer pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve³⁴ për vitet 2007 – 2019 dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, pranë Ministrisë së Arsimit³⁵.

64. Në vijim, nga analizimi në harmoni i deklaramenteve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit³⁶ dhe dokumentacionit të depozituar prej tij në mbështetje të tyre, duket se shuma prej 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekësh, deklaruar si marrë hua nga babai dhe e referuar se ka shërbyer për pagesën e kështit të parë të pasurisë objekt vlerësimi, ka si burim: (i) kursimet e babait (prindërve) të subjektit ndër vite; dhe (ii) dy huat e pretenduara si të marra nga babai në janar të vitit 2013.

65. Përpos faktit se në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, duket se babai i subjektit bën pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët kanë pasur detyrimin për deklarament në deklaratën *Vetting*³⁷, Komisioni paraprakisht vlerëson se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, e cila është një deklaratë specifike e plotësuar kryesisht bazuar dhe në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor që krahas deklaramentit të pasurisë (në këtë rast të apartamentit në Tiranë), të deklaronte dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor edhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për likuidimin e kësteve për shlyerjen e çmimit të blerjes së saj.

66. Bazuar në pikën 7 të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, me nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaramentit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarament të pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim që për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme,

³⁰Dokumenti, deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2020, redaktuar nga noteri publik A. M., depozituar nga subjekti, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1.

³¹Referojuni përgjigjeve të pyetjes nr. 11, në “procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit të deklaramentit të pasurive”, të datës 4.3.2016, i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021, të ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.10.2021.

³²Pyetja nr. 4 (v), e pyetësorit nr. 2.

³³Ka depozituar kopje të dokumentit noterial, kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2000, redaktuar nga noteri publik M. M.

³⁴Ka depozituar kopje të dokumentit, vërtetim nr. *** prot., datë 4.5.2020, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

³⁵Ka depozituar kopje të dokumentit, vërtetim nr. *** prot., datë 5.5.2020, lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, pranë Ministrisë së Arsimit.

³⁶Përfshirë edhe deklaramentet e dhëna për burimin e krijimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për pagesën e kështit të dytë të pasurisë objekt vlerësimi.

³⁷Analiza e detajuar e personave të lidhur, pasqyruar në pikën 3, të këtij materiali.

likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., të deklaronte burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacion ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të secilës pasuri, në momentin e krijimit të tyre.

67. Sa më sipër, konstatohet se dy huat e pretenduara si të marra nga babai i subjektit të rivlerësimit nga persona të tretë në janar të vitit 2013, nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi apo i detyrimit financiar të lindur në atë periudhë - shumë së pretenduar të marrë hua prej babait i tij. Si rrjedhim, nuk janë përfshirë si të ardhura në analizën financiare paraprake të huadhënësit A. B. këto dy vlera të pretenduara si të marra hua prej tij në janar të vitit 2013.

68. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar mbi burimin e të ardhurave të familjes P. dhe/apo hallës së tij, znj. M. M., si dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor në mbështetje të deklarimeve të tij - për të provuar ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave të këtyre shtetaseve që mund të kenë shërbyer për dhënien e huave babait të tij mbështetur në detyrimin sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016³⁸.

69. Gjithashtu, rezulton se babai i subjektit A. B. në janar të vitit 2013 (momentin e marrjes së dy huave të pretenduara) ka disponuar në llogari bankare vlerën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, llogari të cilën e ka shtuar në vijim në muajin korrik të vitit 2013 me shumën prej 1,000,000 (një milion) lekë.

70. Në vijim, Komisioni verifikoi dhe analizoi në mënyrë logjike të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit në raport me pasuritë e krijuara prej tyre për periudhën para dhe gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

71. Rezulton se në datën 6.9.2000, babai i subjektit të rivlerësimit A. B. ka porositur³⁹ pasurinë e llojit "apartament banimi", me sip. 90 m², të ndodhur në "****", Tiranë, për vlerën 4,200,000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë. Në këtë kontratë është përcaktuar plani i pagesave si vijon: porositësi do të paguajë sipërmarrësin në shumën 100,000 (një milion) lekë, shumë e cila është likuiduar me nënshkrimin e kontratës; si dhe pjesa e mbetur në shumën 4,100,000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë do të jepet brenda datës 25.9.2000.

72. Subjekti ka pretenduar se të ardhurat në shumën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë nga shitja në datën 22.9.2000 e apartamentit të prindërve në qytetin e Fierit kanë shërbyer si burim për krijimin e një pjese të shumës së dhënë hua nga babai i tij në vitin 2013. Ka depozituar si provë – deklaratën noteriale të datës 18.9.2000, të shtetasit A. C. (palës shitëse të apartamentit në Tiranë), në referim të së cilës deklaroi se ka marrë në këtë datë prej shtetasit A. B. shumën 4,100,000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë, sipas kontratës së porosisë, datë 6.9.2000.

73. Komisioni konstaton se të ardhurat e provuara me dokumentacion justifikues ligjor nga prindërit e subjektit të rivlerësimit deri para porositjes së apartamentit në Tiranë dhe kryerjes së pagesës prej 4,100,000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë në datën 18.9.2000, janë në total më pak se 1/3 e çmimit të blerjes së kësaj pasurie [rreth 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë].

74. Në këtë këndvështrim, duket se të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Fier janë përdorur për likuidimin e çmimit të apartamentit të porositur në Tiranë.

75. Për më tepër, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier⁴⁰, informon se shtetasit A. B. dhe A. B. (prindërit e subjektit) kanë në pronësi pasurinë e llojit "apartament", me sipërfaqe 72.6 m², z. k. ****, nr. pasurie ****, vol. ****, f. ****. Kjo pasuri duket se është e njëjta pasuri (regjistruar në

³⁸Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

³⁹Kontratë sipërmarrjeje nr. **** rep., nr. **** kol., datë 6.9.2000, redaktuar nga noteri publik D. K..

⁴⁰Shkresë nr. **** prot., datë 3.6.2020, protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 3.6.2020.

regjistrin hipotekor nr. ***, datë 21.7.2000), për të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është shitur prej tyre në datën 22.9.2000, duke depozituar edhe kontratën noteriale të shitblerjes.

76. Gjithashtu, Komisioni evidentoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur në datën 21.6.2009 gjendje në llogarinë e tij në “ProCredit Bank”⁴¹, shumën 1,183,376 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë dhe se në datën 22.6.2009 ka transferuar nga kjo llogari në favor të subjektit të rivlerësimit (llogarinë e tij në “ProCredit Bank”) shumën 515,000 (pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Në vijim, rezultoi se nga llogaria e tij në “ProCredit Bank”, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në datën 22.9.2009, shumën prej 220,000 (dyqind e njëzet mijë) lekësh dhe se gjendja e saj në datën 12.10.2009 (data e fillimit të detyrës) ka qenë 300,000 (treqind mijë) lekë.

77. Referuar deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar se shuma prej 300,000 (treqind mijë) lekësh në “ProCredit Bank” ka si burim kursimet e ushtrimit të profesionit të avokatit. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se në këtë formular, në seksionin “deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme/pasuritë e luajtshme”, subjekti ka deklaruar apartamentin në Tiranë, të blerë nga prindërit (apartament në të cilin banonte), si dhe se zotëron 80% të shumës prej 900,000 (nëntëqind mijë) lekësh të deklaruar *cash*. Lidhur me deklarinimin e shumës 900,000 (nëntëqind mijë) lekë *cash*, subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se vlera prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh (20% e shumës) ka qenë gjendje *cash* e babait e krijuar nga kursimet familjare të tij.

78. Nga analizimi në harmoni i të gjithë të dhënave të mësipërme, si dhe në konsideratë të faktit se babai i subjektit të rivlerësimit ka dalë në pension më 1.9.2006 dhe nëna ka dalë në pension të parakohshëm (si ish-ushtarake) që prej vitit 1999 dhe në pension pleqërie prej korrikut të vitit 2007, duket i logjikshëm dhe i pranueshëm fakti se babai i subjektit të rivlerësimit ka disponuar në momentin para fillimit të detyrës së djalit Ervin Beqiri, shumën prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh gjendje *cash*, krahas pasurisë së llojit “apartament banimi”, në Tiranë dhe gjendjes së llogarisë në “ProCredit Bank”, me burim krijimi të ardhurat nga puna, ndër vite, duke konsideruar se të gjithë të ardhurat e mëparshme të tyre janë shpenzuar në krijimin e këtyre pasurive.

79. Sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare, me rezervë, të prindërve të subjektit të rivlerësimit, për të evidentuar mundësinë e kursimit për periudhën nga momenti i fillimit të detyrës së subjektit, deri në dhjetor të vitit 2012 (para dhënies së huas), të pasqyruar në tabelën vijuese.

Analiza financiare e prindërve të subjektit për periudhën 2009 – 2012 (vlerat në lekë)	
Kursime para vitit 2009	180,000
Të ardhura 2009 – 2012	2,772,943
Të ardhura nga interesat bankare	168,915
Shpenzime minimale jetike 2009 – 2012	1,101,768
Investime në depozitë me afat 2009 – 2012	413,158
Mundësia për kursim	1,606,932

80. Sa më sipër, duket se babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas në shumën 5,100,000 lekë në datën 25.1.2013. Si rrjedhim, ky burim i deklaruar nuk do të përfshihet në analizën financiare paraprake për pagesën së kështit të parë të pasurisë objekt vlerësimi.

81. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, barrën e provës për të dhënë argumente dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

⁴¹Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.5.2020.

82. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova sa vijon.

a) Lidhur me burimet e ligjshme të huadhënësve, subjekti deklaroi se marrja e shumës prej 1,000,000 (një milion) lekësh nga shtetasja M. M. (B.), që është motra e shtetasit A. B., është vërtetuar me deklaratën e thjeshtë me shkrim të datës 22.1.2013, të nënshkruar vetëm midis këtyre dy shtetasve duke pasur parasysh se janë motër e vëlla me njëri-tjetrin, ku shtetasja M. M. ka deklaruar: “Sot, më 22.1.2013, unë M. M. deklaroj se i kam dhënë vëllait tim A. B. një shumë hua prej 1,000,000 (një milion) lekësh të reja nga kursimet e mia personale me qëllim për të ndihmuar djalin e tij (nipin tim) Ervin Beqiri për të blerë një apartament në qytetin e Tiranës. Kjo shumë e dhënë hua do të kthehet në çdo kohë që ai do të ketë mundësi për t'i kthyer ato”. Marrja dhe kthimi plotësisht i kësaj shume të hollash vërtetohet edhe me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2020, të nënshkruar përpara noterit A. M. të Dhomës së Noterisë Tiranë, ku kjo shtetase ka deklaruar se: “Unë M. M. deklaroj nën përgjegjësinë time personale me njohje të plotë që sjell një deklaram i pavërtetë se në datën 22.1.2013 i kam dhënë vëllait tim z. A. B. një shumë të hollash prej 1,000,000 (një milion) lekë nga kursimet e punës sime personale dhe këto të holla ia kam dhënë vëllait tim me qëllim që ky i fundit të ndihmonte djalin e tij Ervin Beqiri (nipin tim), për të blerë një apartament banimi në qytetin e Tiranës. Këtë shumë prej 1,000,000 (një milion) lekësh deklaroj se vëllai im A. B. ma ka kthyer gradualisht, deri në vitin 2016. Deklaroj se vëllai im A. B. nuk ka më asnjë detyrim financiar tjetër ndaj meje”.

Në përmbushje të detyrimit të barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti paraqiti prova të reja shkresore për shtetasen M. M., duke sqaruar se si burim të ardhurash për krijimin dhe dhënien hua të shumës kanë shërbyer paga dhe fitimet e siguruar nga aktiviteti tregtar i saj si farmacistë që nga viti 1996, e regjistruar si Person Fizik me NIPT ***, në datën 15.1.1996, me objekt të ushtrimit të aktivitetit “tregtim me pakicë të artikujve farmaceutikë dhe kozmetikë”. Subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe dokumentacion justifikues ligjor.

Trupi gjykues, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin provues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, shpjegimet dhe qëndrimin e tij, të vlerësuara në raport me dokumentacionin e rezultuar gjatë hetimit administrativ, ka çmuar të mos pranojë këtë huadhënie si burim për krijimin e shumës së dhënë hua nga babi, për disa arsye. Së pari, ky burim nuk është deklaruar më herët as në deklaratën noteriale të lëshuar nga huadhënësi, shtetasi A. B., në vitin 2014 (ku ka cituar burimet që kanë shërbyer, të ardhurat) dhe as në pyetësorët në ILDKPKI në mars të vitit 2016. Po ashtu, vetë huadhënësi, shtetasi A. B. (babai i subjektit), ka pasur gjendje likuiditetesh në bankë në këtë periudhë dhe marrja e një shume hua një të treti nuk duket logjike e arsyeshme/bindëse për trupin gjykues, aq më tepër e paraqitur gjatë rezultateve të hetimit kur vetë huadhënësi rezultonte në pamundësi financiare

Në vijim, trupi gjykues çmon se ekzistenca e kësaj huaje mbetet në nivel deklarativ, e paprovuar me ndonjë dokumentacion të kohës (që përbën vlerë provuese), dhe se ajo është shtuar vetëm gjatë hetimit administrativ, pasi vetë huadhënësi rezultonte në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e shumës, ndaj nuk e pranon atë.

b) Marrja e shumës 800,000 (tetëqind mijë) lekë shtetasve Th. dhe E. P., miq të ngushtë të familjes me deklaratën e thjeshtë me shkrim të datës 25.1.2013, të nënshkruar nga të dyja palët, ku këta shtetas kanë deklaruar se: “Sot, në datën 25.1.2013, ne Th. P. dhe E. P. deklarojmë se i kemi dhënë hua shtetasit A. B. një shumë prej 800,000 (tetëqind mijë) lekësh të reja për të ndihmuar djalin e tij Ervin Beqiri për të blerë një apartament në qytetin e Tiranës. Kjo shumë e dhënë hua do të kthehet brenda vitit 2016 dhe për këtë shumë nuk do të paguhet asnjë interes. Unë, A. B., deklaroj dhe pranoj se i kam marrë hua shtetasve Th. dhe E. P. shumën prej 800,000 (tetëqind mijë) lekësh, të cilat deklaroj se do t'i kthej brenda vitit 2016”.

Marrja dhe kthimi plotësisht i kësaj shume të hollash vërtetohet edhe me Deklaratën Noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2020, të nënshkruar përpara noterit P. B. të Dhomës së Noterisë Tiranë, ku këta shtetas kanë deklaruar: “Ne deklaruesit Th. P. dhe E. P. deklarojmë

se i kemi dhënë në datën 25.1.2013 shtetasit A. B. një shumë hua prej 800,000 (tetëqind mijë) lekësh. Me këtë deklaratë, deklarojmë se shtetasi A. B. e ka shlyer plotësisht shumën e marrë hua prej nesh prej 800,000 (tetëqind mijë) lekësh, vlerë të cilën e ka shlyer gjatë vitit 2016. Me këtë deklaratë noteriale deklarojmë se ky shtetas nuk ka asnjë detyrim ndaj nesh. Sot, me nënshkrimin e deklaratës deklarojmë se nuk kemi pasur asnjëherë marrëdhënie detyrimi me z. Ervin Beqiri dhe se marrëdhënia jonë ka qenë vetëm me z. A. B. ”.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin dhe dhënien e shumës prej 800,000 (tetëqind mijë) lekësh shtetasit A. B. subjekti ka paraqitur dokumentacion provues. Subjekti sqaron se vetëm për periudhën janar 2007 – dhjetor 2012, nga të ardhurat vetëm nga paga mujore të këtyre shtetasve duke ndjekur metodologjinë e Komisionit dhe duke zbritur shpenzimet jetike për këtë periudhë kohore, rezulton se shtetasit Th. dhe E. P. kanë pasur mundësi të kursenin dhe të jepnin nga të ardhurat ligjore shumën 800,000 (tetëqind mijë) lekë, duke kundërshtuar barrën e provës.

Trupi gjykues, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin provues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, shpjegimet dhe qëndrimin e tij, të vlerësuara në raport me dokumentacionin e rezultuar gjatë hetimit administrativ, ka çmuar të mos pranojë këtë huadhënie si burim për krijimin e shumës së dhënë hua nga babai i tij, pasi huadhënësi, shtetasi A. B. (babai i subjektit), ka pasur gjendje likuiditetesh në bankë në këtë periudhë dhe marrja e një shume hua një të treti nuk duket logjike e arsyeshme për trupin gjykues. Po ashtu, ky burim nuk është deklaruar më herët as në deklaratën noteriale të lëshuar nga vetë huadhënësi, shtetasi A. B., në vitin 2014 dhe as në pyetësorët në ILDKPKI në mars të vitit 2016.

Në vijim, trupi gjykues çmon se ekzistenca e kësaj huaje mbetet në nivel deklarativ, e paprovuar me ndonjë dokumentacion të kohës (që përbën vlerë provuese), dhe se ajo është shtuar vetëm gjatë hetimit administrativ, pasi vetë huadhënësi rezultonte në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e shumës, ndaj nuk e pranon atë.

c) Subjekti ka kërkuar përfshirjen në analizë financiare si të ardhur për prindërit e tij të shumës 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, e përfituar nga shitja e pasurisë së paluajtshme, apartament në qytetin e Fierit, shtetasve V. L. T. dhe L. L. T., në vitin 2000. Konkretisht, subjekti shprehet se: *“Në analizën ekonomike dhe ligjore të të ardhurave të prindërve të mi konstatohet se nga ana e Komisionit nuk është përfshirë dhe nuk është llogaritur gabimisht dhe një shumë prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, e cila është përfituar në mënyrë ligjore nga shitja e një pasurie të paluajtshme me anë të Kontratës së Shitblerjes Noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.9.2000, përpara noterit publik M. M. të Dhomës së Noterisë Fier, për pasurinë e paluajtshme të llojit ‘apartament’ me numër pasurie ***, që ka qenë në pronësinë e prindërve të mi në qytetin e Fierit dhe që u është shitur shtetasve V. L. T., i vitlindjes 1960, dhe L. L. T., e vitlindjes 1962. Nga ana e Komisionit nuk është vlerësuar dhe përfshirë në analizën financiare kjo shumë e përfituar nga kjo kontratë shitblerjeje, bazuar në konstatimin se: (1) në bazë të një përgjigjeje me nr. *** prot., datë 3.6.2020, të ASHK-së Fier rezulton se pasuria e paluajtshme e llojit ‘apartament’ me numër pasurie *** e shitur nga prindërit e mi vazhdon të jetë e regjistruar ende në pronësinë e prindërve të mi A. dhe A. B..*

*Me qëllim sqarimin e kësaj shtate, nga ana e prindërve të mi i është drejtuar me kërkesë ASHK-së Fier, ku i është kërkuar informacion nëse Kontrata e Shitblerjes së pasurisë të paluajtshme me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 22.9.2000, të kryer përpara noterit publik M. M., është dorëzuar/aplikuar për regjistrim pranë ish-ZVRPP-së Fier (aktualisht AKSH Fier), pas lidhjes së kontratës e në vazhdim, nga ana e shtetasve V. L. T., i vitlindjes 1960, dhe L. L. T., e vitlindjes 1962, dhe nëse po kur është regjistruar/aplikuar për kalimin e pronësisë dhe pse rezulton ende e regjistruar zyrtarisht në emrin tonë, po nga ana e këtij institucioni nuk është kthyer ende përgjigje deri ditën e sotme.*

Deklarimi në DVP-në e vitit 2009 se gjendja cash në shumën 900,000 (nëntëqind mijë) lekë dhe pjesa takuese e subjektit është 80%, të shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, nuk duhet

të merret nga ana e Komisionit si një deklaram që kursimet e prindërve të mi deri në fillim të detyrës sime kanë qenë vetëm 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Shuma prej 180,000 lekësh është pjesë e shumës 900,000 lekë, që disponohej prej subjektit, por jo që të gjitha ishin para të kursyera nga ana ime dhe unë zotëroja 100% të të gjithë kësaj shume”.

Në vijim, trupi gjykues çmoi se pretendimi i subjektit për ta konsideruar këtë të ardhur të vitit 2000 si pjesë të gjendjes *cash* të babait të tij në fund të vitin 2012 dhe, për pasojë, edhe si burim për dhënien e huas në vlerën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë, nuk është pranuar. Së pari, prindërit e subjektit kanë krijuar menjëherë pas shitjes së pasurisë apartament në Fier një pasuri të paluajtshme tjetër, në të njëjtin vit dhe në një vlerë disa herë më shumë se vlera e pasurisë që shitën në Fier. Së dyti, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vitin 2009, në DPV-në para fillimit të detyrës, shumën 900,000 (nëntëqind mijë) lekë dhe pjesë takuese 80% [duke mbetur vlera prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh si gjendje *cash* e babait të tij]. Komisioni vë në dukje se subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën njësi familjare me prindërit e tij, motrat dhe mbesën në DPV-në e vitit 2009 dhe se fakti që ka deklaruar 80% të gjendjes *cash* në banesë i është referuar pjesës së tij takuese të gjendjes *cash* familjar. Së treti, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ shton si burim kursimi të babai i tij edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier në vitin 2000, burim i cili nuk gjen gjurmë as në deklaratën *Vetting*, as në deklaratat periodike vjetore dhe as në procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja më herët.

Ky deklaram i subjektit mbetet deklarativ i pambështetur në dokumentacion provues dhe se duke marrë shkas edhe kohën e gjatë të kaluar, më shumë se 12 vjet, nuk duket bindës. Për këto arsye, trupi gjykues ka vendosur të mos e pranojë këtë shumë si burim të të ardhurave për krijimin e shumës së dhënë hua prej 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë.

ç) Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në prapësimet e tij që të përfshihen në analizën financiare si burim për krijimin e huas së dhënë nga babai, të ardhurat e motrave të tij, pasi kanë qenë në një trung familjar me prindërit dhe nga kjo bashkëjetesë janë krijuar edhe kursime të përbashkëta. Subjekti ka kërkuar të llogariten të ardhurat nga punësimet e motrave të tij A. dhe F. B., të cilat vetëm për vitet 2009 – 2012 duke zbritur shpenzimet jetike, rezulton mundësia për të kursyer gjithsej shumën 3,580,284 (tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë dhe se kanë të ardhura ligjore të mjaftueshme për pagesën e këstit të parë dhe të dytë, edhe sikur të mos llogariteshin fare të ardhurat nga huaja e shtetasve M. M., Th. dhe E. P..

Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe shqyrtoi dokumentacionin përkatës lidhur me të ardhurat e motrave, i vlerësoi ato edhe në raport me rezultatet e hetimit, çmon se ato kanë jetuar në një trung familjar me prindërit e tyre dhe se kanë pasur një ekonomi të përbashkët duke pranuar burimin e krijimit të të ardhurave familjare si gjendje *cash* ashtu edhe likuiditetet në bankë janë rezultat i kursimeve kumulative të krijuara nga të ardhurat e përbashkëta familjare të prindërve dhe dy motrave. Trupi gjykues ka vlerësuar të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2009 – 2012, si dhe të ardhurat e motrave të tij për të njëjtën periudhë (duke u mbështetur në arsyetimin më lart këtij vendimi lidhur me deklaramet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009), nga e cila rezulton se për krijimin e shumës 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë, të dhënë hua në janar të vitit 2013, ata kanë disponuar si vlerë *cash* 4,412,009 (katër milionë e katërqind e dymbëdhjetë mijë e nëntë) lekësh. Në pranimin e këtyre të ardhurave si pjesë e shumës së dhënë hua nga babai, Trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se kjo ka qenë hua e cila është kthyer në vitet pasuese duke u përfshirë në analizën financiare si e ardhur dhe si shpenzim.

Analiza financiare e prindërve të subjektit 2009 – 2012		vlerat në lekë
Kursime para vitit 2009		180,000
Të ardhura 2009 – 2012		2,772,943
Të ardhura nga interesat bankare		168,915
Hua të tjera (në shumën 1,800,000 lekë)		0

Shpenzime minimale jetike 2009 – 2012	1,101,768
Shtesa/pakësime në depozitë me afat 2009 – 2012	413,158
(1) Mundësia për kursim prindërit	1,606,932
Analiza financiare e motrave të subjektit 2009 – 2012	vlerat në lekë
Të ardhurat nga pagat e motrave	4,889,749
Shpenzime minimale jetike motrat + vajza e motrës	1,652,652
Të ardhura nga interesat bankar	102,172
Shtesa/pakësime në depozitë me afat (motrat)	534,192
(2) Mundësia për kursim motrat	2,805,077
(3) Mundësi për kursim familja (prindërit + motra)	4,412,009
Hua dhënë subjektit (5,100,000 më 1/2013)	5,100,000
(4) Rezultati <i>neto</i>	- 687,991

83. Trupi gjykues çmon në përfundim se huadhënësi A. B. rezulton në pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje në vlerën -687,991 (gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë. Në përfundim, trupi gjykues ka çmuar ta përfshijë këtë huadhënie në analizën financiare, duke konsideruar të ardhura të ligjshme vetëm vlerën prej 4,412,009 (katër milionë e katërqind e dymbëdhjetë mijë e nëntë) lekë.

84. Nga analiza financiare e rishikuar pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për pagesën e kështit të parë të pasurisë apartament banimi me sip. 104,18 m², në Tiranë, në rrugën “Shefqet Musaraj”, në shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro (7,010,500 lekë, konvertuar sipas kursit mesatar të këmbimit) subjekti rezulton në pamundësi financiare në shumën -945,914 (nëntëqind e dyzetë e pesë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) lekë.

Analiza financiare për shlyerjen e kështit të parë (deri në datën 25.1.2013)	Vlerat në lekë
Apartament banimi, paguar në datën 25.1.2013, shuma prej 50,000 euro	7,010,500
Hua nga babai (5,100,000 lekë)	4,412,009
Cash në banesë (1,930,000 lekë)	1,652,577
Rezultati financiar	- 945,914

b) Lidhur me pagesën e kështit të dytë në shumën prej 30,000 euro

85. Në kontratën e sipërmarrjes për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi është përcaktuar se kështit i dytë me vlerë 30,000 (tridhjetë mijë) euro do të likuideohej në fund të majit të vitit 2013. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar se pagesa e kështit të dytë në shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro [konvertuar në vlerën 4,215,000 (katër milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë] është kryer më 22.7.2013, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me anë të transaksionit bankar në “Alpha Bank”.

86. Shoqëria “****”⁴² sh.p.k. ka konfirmuar se në datën 22.7.2013 është kryer transfera nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e saj, e shumës 4,215,000 (katër milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, e barasvlershme me vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, sipas kursit të këmbimit të momentit të kryerjes së kësaj transferte. Kjo shoqëri ka depozituar kopje të dokumentit “nxjerrje llogarie” nga “Alpha Bank”, nga ku duket se në datën 22.7.2013 në llogari është transferuar nga shtetasi Ervin Beqiri shuma prej 4,215,000 (katër milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh me përshkrimin “kalim nga Ervin Beqiri te ‘***’ sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2013 (ekuivalenti 30,000 euro)”.

87. Sikurse u evidentua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim për kryerjen e kësaj pagese ka shërbyer tërheqja e të gjithë shumës së depozituar në “Alpha Bank” në emrin e tij dhe se për krijimin e kësaj depozite bankare ka shërbyer bashkimi i të gjitha depozitave bankare në këtë bankë në emrin e tij dhe të bashkëshortes, Xh. B., si dhe nga depozitimi në datën 6.3.2013 në llogarinë e bashkëshortes në “Alpha Bank” të një shume prej 1,200,000 (një

⁴²Shkresa nr. *** prot., datë 27.10.2021e shoqërisë “****” sh.p.k., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.10.2021.

milion e dyqind mijë) lekësh, të marrë hua babait të tij, A. B., dhe të shlyer tërësisht gjatë vitit 2013 me kursimet e këtij viti.

88. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ⁴³ për llogaritë e subjektit dhe bashkëshortes, rezulton se:

i) Në datën 27.5.2008, subjekti ka depozituar *cash* në “Alpha Bank” (në llogarinë në emrin e tij, me nr. ***) vlerën prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 1-vjeçar. Kjo shumë duket se përfaqëson dëmshpërblimin e përfituar nga subjekti i rivlerësimit në datën 27.11.2007, si rrjedhojë e largimit pa të drejtë nga puna, nga punëdhënësi “Raiffeisen Bank”.

Në datën 27.11.2007 subjekti ka tërhequr shumën 626,000 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe duket se brenda ditës ai ka investuar në depozitë me afat në këtë bankë, shumën prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh. Në vijim, në datën 27.5.2008 subjekti ka tërhequr *cash* nga kjo llogari shumën 510,170 (pesëqind e dhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë, nga e cila shumën prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh duket se e ka depozituar në “Alpha Bank” – evidentuar si më sipër.

ii) Në datën 27.5.2009, pas maturimit të depozitës (në “Alpha Bank”), gjendja e saj prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh së bashku me interesat e përfituara, pra, në total shuma 533,750 (pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, ka kaluar në depozitë me afat 3-mujore në llogarinë (nr. ***) në emër të subjektit, pranë të njëjtës bankë.

iii) Në datën 27.8.2009, pas maturimit të depozitës 3-mujore, nga gjendja e llogarisë me nr. ***, subjekti ka tërhequr *cash* interesat e akumuluar në shumën 39,500 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë duke e kaluar pjesën tjetër, shumën prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh, në depozitë me afat 1-vjeçar. Gjendja e kësaj depozite në datën 31.12.2009 ka qenë në shumën 500,000 (pesëqind mijë) lekë. Ndërsa, gjendja e llogarisë me nr. ***, në datën 31.12.2009 ka qenë në shumën 6,618 (gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë nga interesat e krijuara.

Rezulton se në DIP-në para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit depozitë me afat 1-vjeçar në “Alpha Bank”, me vlerë 500,000 (pesëqind mijë) lekë, hapur në datën 27.8.2009, me burim krijimi të ardhurat e përfituara nga dëmshpërblimi për largim pa të drejtë nga puna (proces gjyqësor).

iv) Në datën 31.8.2010, pas maturimit të depozitës në shumën 500,000 (pesëqind mijë) lekë dhe përfitimit të interesave kreditore në shumën 33,902 (tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dy) lekë, subjekti ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar pranë të njëjtës bankë në shumën 533,902 (pesëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dy) lekë.

v) Në datën 31.8.2011, pas maturimit të depozitës në shumën 533,902 (pesëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dy) lekë dhe përfitimit të interesave kreditore [total rreth 32,675 (tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë], si dhe pas kryerjes së një depozitimi *cash* në shumën 440,000 (katërqind e dyzetë mijë) lekë (datë 31.8.2011), subjekti ka investuar në depozitë me afat shumën 1,006,630 (një milion e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë.

vi) Në datën 6.3.2013, në llogarinë e subjektit në “Alpha Bank” është kredituar shuma prej 3,092,000 (tre milionë e nëntëdhjetë e dy mijë) lekësh, transferuar nga llogaria e bashkëshortes së tij në të njëjtën bankë, ku rezulton se:

a) në datën 21.4.2010 personi i lidhur (bashkëshortja) ka depozituar *cash* në “Alpha Bank” (në llogarinë në emër të saj me nr. ***) vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 6-mujor;

⁴³Shkresa me nr. *** prot., datë 4.5.2020, e “Alpha Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.5.2020; (ii) shkresa me nr. *** prot., datë 6.5.2020, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.5.2020; (iii) shkresa nr. *** prot., datë 22.11.2021, e “Alpha Bank” (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.11.2021).

b) në datën 21.10.2010, pas maturimit të kësaj depozite, gjendja prej 400,000 (katërqind mijë) lekësh së bashku me interesat kreditore në shumën 10,468 (dhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, si edhe me shumën prej 300,000 (treqind mijë) lekësh të depozituar *cash* nga personi i lidhur, janë kaluar nga shtetasi XH. B., në depozitë me afat 3-mujor [në total shuma 710,468 (shtatëqind e dhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë];

c) në datën 14.1.2011, personi i lidhur ka depozituar *cash* shumën 300,000 (treqind mijë) lekë në këtë llogari;

ç) në datën 21.1.2011, pas maturimit të depozitës në shumën 710,468 (shtatëqind e dhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë dhe përfitimit të interesave kreditore në shumën prej 7,414 (shtatë mijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekësh dhe bashkimit me shumën 300,000 (treqind mijë) lekë, e cila ishte depozituar në datën 14.1.2011 nga personi i lidhur, ajo ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar shumën 1,017,882 (një milion e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë;

d) në datën 21.7.2011, personi i lidhur (bashkëshortja) ka depozituar në të njëjtën llogari shumën 460,000 (katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë duke e investuar në depozitë me afat 6-mujor;

dh) në datën 23.1.2012 janë maturuar: (i) depozita në shumën 1,017,882 (një milion e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë, duke u përfituar interesat kreditore në shumën 50,584 (pesëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë; (ii) depozita në shumën 460,000 (katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, duke u përfituar interesat kreditore në shumën 11,478 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë. Po në këtë datë, nga shtetasi XH. B. është depozituar *cash* shuma 261,000 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë dhe, në vijim, ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar shumën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë;

e) në datën 25.1.2013 nga shtetasi XH. B. është mbyllur depozita [e investuar më parë në vitin 2012 në shumën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë] dhe janë përfituar interesat kreditore në shumën 88,297 (tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, të cilat janë investuar në depozitë me afat në total shuma 1,888,297 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë;

ë) në datën 6.3.2013, në llogarinë e personit të lidhur depozitë në “Alpha Bank”, nga shtetasi XH. B., është depozituar *cash* shuma prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh me përshkrimin “Xh. B. derdhje në llogari për transfertë”. Gjithashtu, rezulton se është mbyllur para afatit depozita në shumën 1,888,297 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, duke përfituar interesat kreditore në shumën 4,330 (katër mijë e treqind e tridhjetë) lekë. Po në të njëjtën datë, personi i lidhur/bashkëshortja ka transferuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Alpha Bank”, shumën prej 3,092,000 (tre milionë e nëntëdhjetë e dy mijë) lekësh.

vii) Në datën 8.3.2013 është mbyllur para afatit depozita e subjektit [e investuar më parë në vitin 2011 në shumën 1,006,630 (një milion e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë] dhe janë përfituar interesat kreditore në shumën 73,686 (shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, të cilat së bashku me shumën 3,092,000 (tre milionë e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, të transferuar nga bashkëshortja, janë investuar në depozitë me afat 3-mujor, në shumën 4,172,317 (katër milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë;

viii) Në datën 10.6.2013, pas maturimit të depozitës në shumën 4,172,317 (katër milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë dhe përfitimit të interesave kreditore [total rreth 40,699 (dyzet mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë] gjendja në llogarinë e subjektit ka qenë 4,213,000 (katër milionë e dyqind e tremëdhjetë mijë) lekë;

ix) Në datën 22.7.2013, nga kjo llogari pasi është depozituar shuma 2,000 (dy mijë) lekë nga subjekti është transferuar e gjithë gjendja e kësaj llogarie prej 4,215,000 (katër milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., me përshkrimin: “kalim nga

Ervin Beqiri te ‘***’ sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2013, ekuivalenti i shumës 30,000 (tridhjetë mijë) euro”.

89. Në vijim, Komisioni verifikoi dhe analizoi deklaratimet e bëra dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, të depozituar nga bashkëshortja e subjektit në datën 6.3.2013 në llogarinë e saj në “Alpha Bank”.

90. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se krijimi i depozitës në datën 6.3.2013, në vlerën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë në “Alpha Bank”, në emër të bashkëshortes, ka si burim huan e dhënë nga babai i tij.

91. Më konkretisht, i pyetur sërish nga Komisioni lidhur me këtë vlerë të pretenduar si të marrë hua, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se⁴⁴ shuma prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh është marrë prej babait dhe është deklaruar nga bashkëshortja në faqen nr. 9 të formularit të deklaratimit të vitit 2013, në rubrikën e dytë, por jo në mënyrë të saktë. Në këtë rubrikë është shprehur/shkruar “*shtuar shuma në këtë llogari bankare në shumën prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh nga kursimet familjare në datën 6.3.2013*”, ku në fakt duhet të ishte deklaruar në formularin e deklaratimit si shumë e marrë prej babait të tij, z. A. B., e krijuar nga kursimet familjare të familjes së tij – përbërë nga prindërit dhe motrat, me të cilët jetonte në momentin e deklaratimit.

92. Pasi Komisioni i vuri në dukje faktin se babai i tij nuk kishte konfirmuar dhënien e kësaj shume me dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit nr.2, subjekti i rivlerësimit depozitoi deklaratën noteriale⁴⁵ të babait, z. A. B., të datës 11.11.2021, i cili deklaroi se në mars të vitit 2013 i ka dhënë djalit, z. Ervin Beqiri, një shumë monetare prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë nga kursimet e tij familjare me qëllim blerjen e një apartamenti në qytetin e Tiranës.

93. Nga analizimi në tërësi i deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit si edhe provave të administruara në dosje, në raport edhe me përcaktimet e bëra për mënyrën e deklaratimit të pasurive sipas ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë marrëdhënie huaje të deklaruar gjatë hetimit administrativ, Komisioni evidenton sa vijon:

i) Në DIP-në e vitit 2013 (deklarata e re e plotësuar) në deklarinë e bërë veçmas, personi i lidhur, ndër të tjera, ka deklaruar: “... *shtuar në llogari bankare në datën 6.3.2013, shuma prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, nga kursimet familjare ...*”.

Pra, duket se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 personi i lidhur ka deklaruar se shtesa në llogarinë e saj bankare në datën 6.3.2013, ka si burim krijimi kursimet familjare.

ii) Bazuar në pikën 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 si edhe në përputhje me pikën 7, të Udhëzimit me nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive nga subjektet e rivlerësimit ...”, subjekti ka pasur detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë (apartamentit në Tiranë), si dhe të deklarojë burimin në momentin e krijimit të saj (kryerjen e pagesave për likuidimin e kësteve), duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit në momentin e fitimit të pasurisë.

Duket se subjekti nuk e ka përmbushur këtë detyrim – pasi nuk ka deklaruar specifikisht në deklaratën *Vetting* se për pagesën e kësaj të dytë në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro të ketë shërbyer shuma prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, e marrë hua nga babai i tij, si edhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume.

iii) Në kushtet kur subjekti ka pretenduar se babai i kishte dhënë në janar të vitit 2013 shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë, për krijimin e së cilës kishte marrë hua nga të tretë shumën prej 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, duket se nuk ka logjikë

⁴⁴Referojuni përgjigjeve të pyetjes nr. 4, të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

⁴⁵Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. Dh. Q.

ekonomike që babai i subjektit të dispononte edhe vlera të tjera monetare *cash* [shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, në mars të vitit 2013] – krahas atyre të evidentuara në llogari bankare dhe në të njëjtën kohë të merrte më parë (rreth 40 ditë) hua nga persona të tretë.

iv) Pavarësisht se z. A. B., me deklaratën e datës 11.11.2021, ka konfirmuar dhënien e kësaj shume në favor të djalit të tij – në mars të vitit 2013 duket kontradiktor fakti se pse me deklaratën noteriale të datës 18.3.2014 ai ka deklaruar se i ka dhënë në janar të vitit 2013 shumën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë – duke mos u përmendur shuma tjetër prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, e materializuar në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit në datën 6.3.2013.

94. Sa më sipër, duket se nuk provohet kjo marrëdhënie huaje e pretenduar dhe as ligjshmëria e burimeve të huadhënësit.

95. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si edhe pas verifikimeve të kryera mbi marrëdhënien e pretenduar të huas – trajtuar si më sipër, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur /bashkëshortes për të krijuar në datën 6.3.2013 shtesën në llogari – depozitë bankare të shumës 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, të paraqitur në tabelën vijuese.

Analiza financiare për periudhën 25.1.2013 ⁴⁶ - 6.3.2013	Vlerat në lekë
A) Pasuri	1 205 043
Ndryshim likuiditeti	1 205 043
B) Detyrime	0
C) Pasuri <i>neto</i> (A-B)	1 205 043
D) Të ardhura	188 626
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	166 748
Të ardhura nga paga, bashkëshortja	17 548
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	4 330
E) Shpenzime	46 486
Shpenzime minimale jetike	39 886
Shpenzime për udhëtimin në vendin e punës, në Lezhë, subjekti i rivlerësimit	6 600
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1 062 903

96. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, në datën 6.3.2013, shumë e cila është deklaruar dhe evidentuar se ka shërbyer për pagesën e këstit të dytë – për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit në Tiranë, duke mospranuar deklaratimet e tij për kë huadhënie.

97. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, për të dhënë argumente dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

98. Në vijim të shpjegimeve/prapësimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar sa vijon: *“Rezulton e deklaruar në mënyrë të njëjtë, bindëse dhe pa asnjë ekuivok qëllimi i marrjes dhe dokumentimit të huas prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh nga babai im. Në bazë të DPV-së së vitit 2013, deklaratimit në ILDKPKI në vitin 2016, deklaratës Vetting; përgjigje të pyetësorit nr. 1; pyetësorit nr.2, si dhe Deklaratën Noteriale me nr.*** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2021, të babait tim A. B. ku konfirmohet marrja dhe shlyerja e kësaj shume dhe në mënyrë të saktë kam deklaruar destinacionin dhe qëllimin e marrjes së kësaj shume. Qëllimi i marrjes së saj ka qenë pagesa e këstit të dytë, të cilën unë duhet ta kryeja sipas kontratës së sipërmarrjes në muajin maj të vitit 2013 dhe kam qenë në kushtet e emergjencës sepse mund të*

⁴⁶Të ardhurat e muajit janar të vitit 2013 (deri më 26.1.2013) janë reflektuar në analizën financiare për mundësinë e pagesës së këstit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit në Tiranë, analizë e cila ka rezultuar me balancë negative fondesh.

anulohej kontrata për mospagimin e këstit të dytë dhe mund të humbisja tërësisht pagesën e këstit të parë që unë kisha kryer. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume të dhënë hua nga babai im, edhe në bazë të hetimeve të kryera nga Komisioni, provohet bindshëm se me burime të ligjshme prindërit e mi dhe motrat e mia për periudhën 2009 – 2013 kanë pasur mundësi të kursenin shumën që më dhanë hua, madje nga saktësimet sipas provave të cituara prej meje, mundësia e kursimit rezulton të jetë dukshëm më e lartë sesa vlera e dhënë hua karshi meje. Subjekti ka paraqitur një dokument⁴⁷ nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë mbi përfitim të pensionit suplementar nga prindërit e subjektit, i cili mban datën 13.3.2013”.

99. Trupi gjykues, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin provues të paraqitur prej tij, në raport edhe me rezultatet e hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* huan e pretenduar në shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë, dhënë nga babai i tij, e cila më tej ka shërbyer si burim për derdhjen e kësaj shume në bankë, në datën 6.3.2013, nga bashkëshortja, shtetasja Xh. B. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë huadhënie në DPV-në e vitit 2013 dhe as si burimin për krijimin e depozitës referuese.

100. Huadhënësi (babai i subjektit) rezulton në pamundësi financiare, në mars të vitit 2013, për krijimin e shumës 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë. Po ashtu, pa logjikë të arsyeshme duket kjo huadhënie referuar edhe deklarimeve të huadhënësit A. B., i cili për krijimin e shumës së dhënë hua në janar të këtij viti kishte marrë hua nga persona të tretë. Edhe huadhënësi, që rezulton në pamundësi, ka pasur likuiditete në bankë, të cilat rezultojnë të paprekura, përkundrazi, të shtuara në muajt në vijim.

101. Të ardhurat e pretenduara të prindërve, nga pensionet suplementare kanë një datë të mëvonshme të përfitimit të tyre, në raport me datën e derdhjes në depozitë nga bashkëshortja e subjektit të shumës 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

102. Nga analizimi që i është bërë deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ se ka kthyer këtë hua brenda vitit kalendarik, rezulton se ai ka qenë në pamundësi financiare me të ardhurat e atij viti (mars - dhjetor), po ashtu ai ka pasur vetë gjendje likuiditetesh në bankë deri në 1 mars, rreth 3,808,715 (tre milionë e tetëqind e tetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë nga të cilat ai përdor vetëm shumën prej 2,808,715 (dy milionë e tetëqind e tetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë deri në datën 22.7.2013 dhe pjesën tjetër e mban likuiditet në bankë [bono thesari me vlerë 1,000,000 (një milion) lekë].

103. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaratimet duke shtuar si burim gjatë hetimit administrativ një hua të marrë nga babai i tij në shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë. Trupi gjykues krijon bindjen se këto deklarime të mëvonshme kanë vlerë të kufizuar, pasi rezultojnë si përpjekje për të justifikuar mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit në funksion të përmbysjes së një analize financiare negative.

104. Trupi gjykues ka vlerësuar se Deklarata Noteriale datë 11.11.2021 nga babai, shtetasi A. B., e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për shkak të procesit të tij të rivlerësimit, nuk mundi të prodhojë besueshmëri dhe se ato nuk përputhen me ndonjë provë apo situatë në deklaratat periodike të kohës apo dokumente të tjera të prodhuara në atë kohë, përveç deklarimeve të subjektit.

105. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e shumës 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë në datën 6.3.2013, përdorur në datën 22.7.2013 dhe, për pasojë, nuk e konsideron këtë vlerë si burim të ligjshëm për pagesën e këstit të dytë në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro

⁴⁷Vendimit nr. ***, të datës 13.3.2013, për rishqyrtimin e masës së pensionit nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë; vendimit nr. ***, të datës 29.3.2013, për rishqyrtimin e masës së pensionit nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

(4,215,000 lekë), duke mos e marrë atë në konsideratë në analizën financiare huadhënien si burim.

c) Pagesa e kështit të tretë në shumën 7,000 euro

106. Në kontratën e sipërmarrjes për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi – të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., në datën 26.1.2013, përcaktohet se kështi i tretë prej 8,000 (tetë mijë) euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë.

107. Konstatohet se në DIP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bazuar në Kontratën e Sipërmarrjes të datës 26.1.2013 ka paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 7,000 (shtatë mijë) euro gjatë vitit 2014 dhe detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë në shumën 3,000 (tre mijë) euro – detyrim i cili deklarohet edhe në deklaratën *Vetting*.

108. Ndërsa, gjatë hetimit administrativ subjekti ka shpjeguar se kjo pagesë është kryer *cash* në zyrën e financës së shoqërisë “****” sh.p.k., e vërtetuar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.8.2014⁴⁸, të kësaj shoqërie dhe se burim për kryerjen e kësaj pagese ka shërbyer tërheqja e shumës 1,000,000 (një milion) lekë nga Banka e Shqipërisë në datën 10.4.2014 ,të depozituara në bono thesari, në emër të bashkëshortes Xh. B..

109. Në përfundim, për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 104,18 m², në Tiranë, në rrugën “**”, trupi gjykues çmon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën - 945,914 (nëntëqind e dyzetë e pesë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) lekë për pagesën e kështit të parë dhe vlerën - 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë për pagesën e kështit të dytë, të dyja këto pagesa të realizuara gjatë vitit 2013. Kjo situatë e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e gërmave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

110. Pasuria automjet tip “Mercedes-Benz C 220 CDI”, vit prodhimi 1999, me targa *, blerë në datën 2.3.2012. Burim i krijimi: kursimet familjare.**

111. DPSHTRR-ja⁴⁹ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në emrin e tij automjetin me targa ***. Nga verifikimi i dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja rezulton se në datën 2.3.2012 subjekti i rivlerësimit ka blerë⁵⁰ nga shtetasi A. S. automjetin tip “Daimlerchrysler Mercedes-Benz 220 CDI”, vit prodhimi 1999, me targa ***, për shumën 3,000 (tre mijë) euro. Konstatohet se ky automjet është blerë më parë në Gjermani nga shtetasi A. S., për vlerën 700 (shtatëqind) euro. Procedurat e zhdoganimit janë kryer më 9.1.2012, nga ku duket se vlera statistikore (referenca) e këtij automjeti është shënuar me shumën 118,785 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë dhe është paguar detyrimi doganor në shumën 23,756 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

112. Sa më sipër, Komisioni konstaton se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri, si edhe në konsideratë të faktit se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më parë kursime në formë likuiditetesh *cash*, të cilat pas analizës financiare të kryer mundësojnë disponimin e shumës 3,000 (tre mijë) euro në fund të vitit 2011, duket se nuk ka dyshime për ligjshmërinë e burimeve financiare, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

• Personat e lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016

113. Nga verifikimi i deklaratave të interesave private/periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se për vitin 2009 ka deklaruar se në përbërjen familjare të tij – sipas certifikatës së gjendjes civile kanë qenë edhe prindërit (babai dhe nëna), motrat (A. dhe F. B.) dhe mbesa e tij (N. K.), ndërsa në DIP-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar

⁴⁸Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se apartamentin e porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., e ka marrë në dorëzim në muajt shator -tetor të vitit 2014, por se ka filluar ta përdorë atë nga muaji tetor - dhjetor të vitit 2014 (referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2). Gjithashtu, nga verifikimi i kopjeve të librezave të energjisë elektrike për këtë apartament, duket se konsumi i energjisë elektrike ka filluar në muajin tetor 2014.

⁴⁹Shkresa nr. *** prot., datë 7.5.2020, e DPSHTRR-së.

⁵⁰Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme – automjet me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. Sh. Gj..

se në përbërjen familjare të tij sipas certifikatës së gjendjes civile bën pjesë ai vetë dhe bashkëshortja Xh. B.. Rezulton se subjekti ka lidhur martesë në datën 12.3.2010. Edhe në deklaratat e dorëzuara në vijim, subjekti nuk ka pasqyruar në përbërjen familjare të tij, sipas certifikatës së gjendjes civile, prindërit, motrat dhe mbesën e tij.

114. Ndërkohë, pasi Komisioni i kërkoi të deklarojë në mënyrë kronologjike ndryshimet që kanë ndodhur në gjendjen e tij civile (familjare) ndër vite⁵¹, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se në datën 17.10.2016 është bërë prej tij ndarja nga trangu familjar i prindërve⁵².

115. Nga verifikimi i certifikatave familjare të depozituara konfirmohet se subjekti i rivlerësimit figuron i regjistruar si kryefamiljar që prej datës 17.10.2016, pasi prindërit janë ndarë në familje më vete. Pra, duket se subjekti i rivlerësimit para datës 17.10.2016 ka qenë në përbërje familjare së bashku me prindërit e tij.

116. Referuar nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur të tij.

117. Në pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se “*person i lidhur*” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit.

118. Ndërsa në pikën 12, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se “*periudha e rivlerësimit*” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji.

119. Në pikën 3, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016 është parashikuar se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vjet në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.

120. Rezulton se ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016. Si rrjedhojë, periudha e rivlerësimit për efekt të këtij ligji është nga data 8.10.2013 deri më 8.10.2016.

121. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁵³, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar⁵⁴ certifikatat familjare për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, nga ku rezulton se në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë janë edhe prindërit, dy motrat dhe mbesa e tij.

122. Nga analizimi në harmoni i dispozitave të mësipërme me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstaton se prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe dy motrat e tij bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private. Por, rezulton se me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar deklarime veçmas mbi pasuritë, të ardhurat, detyrimet etj., për personat e lidhur, prindërit dhe motrat e tij.

123. Subjekti i rivlerësimit, pasi Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë mbi investimet e kryera nga prindërit e tij në pasuri të paluajtshme dhe/apo pasuri të luajtshme për periudhën para dhe pas dhënies së huas së pretenduar nga babai deri në fund të vitit 2016, ka evidentuar⁵⁵

⁵¹Pyetja nr. 3, e pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni.

⁵²Subjekti ka depozituar certifikata familjare dhe certifikatë martesë.

⁵³Shkresa nr. *** prot., datë 5.11.2021.

⁵⁴Shkresa nr. *** prot., datë 10.11.2021.

⁵⁵Referojuni përgjigjeve të pyetjes nr. 4, të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

investimin e kryer prej tyre në vitin 2000 për blerjen e apartamentit në Tiranë, por nga ana tjetër duket se ka deklaruar se ata nuk kanë kryer investime të tjera në pasuri të luajtshme deri në fund të vitit 2016.

124. Gjithashtu, pasi iu kërkua të deklarojë mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme (si automjete, likuiditete gjendje në llogari bankare etj.) që dispononin motrat e tij, A. dhe F. B., deri në momentin para dhënies së huave të pretenduara nga babai dhe burimin e krijimit të tyre, duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, se⁵⁶ motrat e tij nuk kanë blerë ose përfituar, nëpërmjet dhurimit ose në çdo formë të tjetër ligjore, asnjë pasuri të paluajtshme dhe/apo të luajtshme të regjistruar sipas ligjit, si dhe nuk kanë pasur të regjistruar në organet shtetërore përpara vitit 2013 dhe nuk kanë as aktualisht asnjë pasuri të paluajtshme dhe/apo të luajtshme të regjistruar në emrin e tyre.

125. Nga hetimi administrativ i kryer, krahas apartamentit të porositur në Tiranë në vitin 2000, Komisioni evidentoi investime të kryera në disa llogari bankare nga personat e lidhur (babai dhe dy motrat e subjektit), me gjendje në datën 28.1.2017 (momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*) si vijon:

- i) investim në bono thesari⁵⁷, babai i subjektit të rivlerësimit, vlera 4,000,000 (katër milionë) lekë;
- ii) investim në bono thesari⁵⁸, motra e subjektit A. B., vlera 2,000,000 (dy milionë) lekë;
- iii) gjendje llogarie bankare në “ProCredit Bank”⁵⁹, motra e subjektit A. B., vlera 3,369 (tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) euro;
- iv) investim në bono thesari⁶⁰, motra e subjektit F. B., vlera 1,670,000 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;
- v) gjendje llogarie depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”⁶¹, motra e subjektit F. B., vlera 1,000,000 (një milion) lekë.

126. Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e pasurive të personave të lidhur. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë pasuritë e personave të lidhur, burimin e krijimit të tyre, si dhe të ardhurat, detyrimet dhe/apo interesat e tjera private, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Deklarimi të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor.

127. Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar sa vijon: *“Në përgjigje të kësaj barre prove unë shpjegoj dhe parashtoj se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të deklaratës *Vetting* që ka qenë data 28.1.2017 në certifikatën e gjendjes civile unë kam qenë në trung familjar të përbërë prej meje bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët e mi të mitur që janë: (a) Ejona Beqiri e datëlindjes 3.6.2013; dhe (b) A. B. e datëlindjes 8.8.2016”. Kjo përbërje familjare e datës 28.1.2017 është pasqyruar me vërtetësi në deklaratën *Vetting* të dorëzuar në ILDKPKI. Deklarata *Vetting* është shoqëruar me certifikatën personale dhe familjare të subjektit të rivlerësimit, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit dhe ka pasqyruar me vërtetësi gjendjen civile të tre muajve të fundit në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, duke qenë në përputhje me pikën 3 të Udhëzimit me nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Inspektori i Përgjithshëm miratoi Udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, në nenin 3 të të cilit përcaktohej se: ‘Deklarata duhet të shoqërohet me certifikatën personale dhe certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit. Bashkëlidhur, subjekti i rivlerësimit duhet të dorëzojë fotokopje të letrës së njoftimit (kartës së*

⁵⁶Referojuni përgjigjeve të pyetjes nr. 4, të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

⁵⁷Shkresa nr. *** prot., datë 5.5.2020, e Bankës së Shqipërisë.

⁵⁸Shkresa nr. *** prot., datë 11.11.2021, e Bankës së Shqipërisë.

⁵⁹Shkresa nr. *** prot., datë 24.11.2021, e “ProCredit Bank”.

⁶⁰Shkresa nr. *** prot., datë 11.11.2021, e Bankës së Shqipërisë.

⁶¹Shkresa nr. *** prot., datë 19.11.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

identitetit) për vete, bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe çdo person, sipas certifikatës familjare'. Në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting edhe nga ana e punonjësit të këtij institucioni nuk më është kërkuar dhe nuk më është vënë në dukje fakti se duhej të dorëzoja deklaratime të plotësuara edhe për pjesëtarët e tjerë të familjes time të origjinës.

Gjithsesi, në analizë të ligjit çmtoj se prindërit dhe motrat e mia nuk janë persona të lidhur me mua. Vlerësoj se të gjithë ata janë persona të tjerë të lidhur me mua vetëm për sa i takon atyre marrëdhënieve që kanë pasur lidhje interesi me mua (në rastin huaje ose dhurimi). Unë kam deklaruar qartësisht se unë marrëdhënien e marrjes së shumave/huas e kam pasur vetëm me babain tim A. B. dhe jo me nënën time ose me motrat e mia.

Gjithsesi, megjithëse vlerësoj se është i pabazuar në ligj si kërkesë meqenëse më është kërkuar shprehimisht nga Komisioni plotësimi i deklaratave të pasurisë dhe, për shkak, se nuk kam për qëllim të fsheh pasurinë time ose të prindërve/motrave të mia po bëj deklarin për secilin prej tyre, bashkëngjitur këtij raporti.

Sqaroj se unë, pavarësisht, se kam qenë në përbërje të certifikatës familjare bashkë me prindërit e mi dhe motrat e mia, isha shkëputur prej tyre fizikisht (de facto) që nga viti 2014 dhe e kam konsideruar veten të ndarë prej tyre që nga ajo kohë që është një kohë shumë e gjatë gati 3-vjeçare deri në momentin e dorëzimit të deklaratave Vetting”.

128. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur deklaratimet e kërkuara nga Komisioni.

129. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte lidhur me familjarët e tij (babai, nëna dhe motrat), në cilësinë e personave të lidhur me të, gjë të cilën duket se ai e ka shmangur me arsyetimin se ishte ndarë nga trangu familjar pas datës 17.10.2016 (deri në atë kohë ka qenë në përbërje familjare së bashku me prindërit e tij dhe motrat). Pasuria e krijuar prej tij në vitin 2013 ka qenë më së shumti e mbështetur financiarisht nga familjarët e tij, të cilët duhet të deklaronin në cilësinë e personave të lidhur dhe jo në cilësinë e personave të tjerë të lidhur. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se edhe ata kanë pasur pasuri të krijuara, ndër vite, si likuiditete bankare.

130. Në përfundim, trupi gjykues çmon subjekti i rivlerësimit ka shmangur nga deklarimi Vetting pasuritë e familjarëve të tij dhe se në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kishte detyrimin për deklarin, duke bërë kështu deklarin të pamjaftueshëm në deklaratën Vetting.

• ÇËSHTJE TË TJERA

131. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se ka transferuar në gjendje *cash* në shtetin italian me anë të një personi tjetër, në favor të avokates I. B., shumat 1,500 (një mijë e pesëqind) euro në vitin 2011 dhe 1,000 (një mijë) euro në vitin 2015 me qëllim për të përballuar shpenzimet gjyqësore dhe të avokatisë në një proces gjyqësor që po zhvillohej në shtetin italian me objekt “dëmshtëpërbliim për humbjen e jetës së shtetasit të quajtur B. A. në ngjarjen e datës 17.10.2003”, ngjarje e ndodhur në Lushnjë dhe për të cilën është deklaruar fajtor një shtetas italian me vendimin gjyqësor me nr. *** Akti, datë 17.6.2009, të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë. Për këtë çështje ai deklaroi se ka qenë i angazhuar profesionalisht si avokat që nga viti 2004 dhe ka dhënë ndihmën e tij me anë të këshillave juridike dhe personale.

132. Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të deklarojë mbi burimin e krijimit të këtyre shumave, për të cilat ka referuar se janë dërguar në shtetin italian, deklarimi të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe të japë shpjegime shteruese lidhur me këtë marrëdhënie të vetëdeklaruar prej tij.

133. Në përgjigje të kësaj barre prove subjekti shpjegon se këto shuma të hollash janë dërguar prej tij në shtetin italian dhe kanë si burim të ardhurat e tij personale. Këto shuma, konkretisht,

njëra në vlerën 1,500 (një mijë e pesëqind) euro dhe tjetra në vlerën 1,000 (një mijë) euro janë dhënë prej tij *cash* shtetasit T. S., i cili i ka dërguar ato në Itali.

134. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: “*Marrëdhënia ka filluar që në vitin 2004 gjatë kohës që unë ushtroja profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 17.10.2003, ku kishte humbur jetën shtetasi B. A., djali i motrës së shtetasit T. S., pasi ishte qëlluar me armë gjahu nga shtetasi italian C. E., ndaj u mendua se kjo çështje do të ishte më fitimprurëse nëse do të ndiqej në shtetin italian, ku kishte selinë shoqëria e sigurimeve italiane dhe vendbanimin shtetasi italian dhe, për rrjedhojë, kemi rënë dakord që çështja të ndiqej nga avokate I. B.. Me këtë avokate kemi rënë dakord pa një aktmarrëveshje, që për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të familjes së shtetasit të ndjerë B. A., nuk do të parapaguhej për punën e kryer nga ana e saj në gjykatat italiane sipas tarifave të këtij shteti, po do paguhej në fund të procesit gjyqësor, fakt për të cilin kjo avokate ka rënë dakord dhe se do të informohej prej shtetasit T. S.. Me qëllim për të garantuar shpërblimin për punën e bërë nga viti 2004 dhe për të garantuar shpenzimet e kryera deri në atë moment dhe në vazhdim dhe duke qenë se këta shtetas ishin në dijeni të plotë se këto procedura do të ndiqeshin nga zyra e avokatisë në shtetin italian për të cilën ishte lëshuar paraprakisht një prokurë e posaçme, u kam kërkuar që të lidhnim një marrëveshje noteriale ku të pasqyrohej fakti i shpërblimit tim. Nga shtetasit L. A., N. A., F. A., A. A. dhe Z. S. është rënë dakord dhe, në këto kushte, janë nënshkruar Prokura e Posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2011 dhe Aktmarrëveshjen noteriale ‘Për realizim kundërshtëpërblimi’ me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2011. Në vitin 2018 jam njoftuar po nga av. I. B. dhe më pas dhe nga palët paditëse se Gjykata Italiane e Vicencës në të cilën po zhvillohej procesi gjyqësor kishte pranuar padinë e ngritur dhe kishte dhënë si dëmshpërblim vlerën prej rreth 990,000 (nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) euro.*

*Në datën 4.6.2018 shtetasit L. A., N. A., F. A. dhe A. A. janë paraqitur në mënyrë të njëanshme përpara një noteri dhe kanë nënshkruar Deklaratën Noteriale ‘Për revokim prokure dhe akt marrëveshje’ me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2018, të nënshkruar përpara noterit K. K. të Dhomës së Noterisë Fier, ku kanë deklaruar se revokojnë prokurën e posaçme për shkak se nuk është kryer asnjë veprim nga ana ime.*

*Nga ana e shtetasit T. S. është lëshuar me kërkesën time një Deklaratë Noteriale me nr.*** rep., nr. *** kol., datë 20.7.2019, ku ka sqaruar të gjitha rrethanat e njohjes me mua dhe të veprimeve të kryera nga ana ime për këtë rast. Gjatë përgatitjes së mbrojtjes nga ana ime kam konstatuar se shtetasi F. A. kishte kryer disa vepra penale dhe, në këto kushte, kam paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier. Aktualisht, ky shtetas është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për akuzën e falsifikimit të dokumenteve të parashikuara nga neni 186/2 i Kodit Penal”.*

135. Subjekti i rivlerësimit, për të vërtetuar sa më sipër, ka paraqitur: (a) Prokurën e Posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.2.2011 dhe Aktmarrëveshjen noteriale “Për realizim kundërshtëpërblimi” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2011; (b) Deklaratën Noteriale “Për revokim prokure dhe akt marrëveshje” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2018, të nënshkruar përpara noterit K. K. të Dhomës së Noterisë Fier; (c) kopje të deklarimeve të dhëna përpara oficerit të policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier; si dhe (ç) kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim për procedimin penal nr. *** të Prokurorisë Fier.

136. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti ka dhënë shpjegime shteruese dhe dokumentacion provues të mjaftueshëm. Shpenzimet e kryera prej tij janë llogaritur në analizën financiare të Komisionit.

137. **Transferta e kryer nga personi i lidhur (bashkëshortja), para lidhjes së martesës.** “Abi Bank”⁶² konfirmon se nga llogaria e personit të lidhur, znj. Xh. M. (B.), në datën

⁶²Shkresa nr. *** prot., datë 11.11.2021, e “Abi Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.11.2021.

22.5.2009 është transferuar në favor të shtetasës J. B. shuma 19,302 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e dy) USD, sipas të dhënave “THE TORONTO-DOMINON BANK, AD.1846 LAWRENCE AVE”, me përshkrimin “transferte personale” (transferte e kryer nga llogaria e personit të lidhur në “NBG Bank”, tashmë “ABI Bank”).

138. Sa më sipër, Komisioni kërkoi nga bashkëshortja Xh. M. (B.)/personi i lidhur të deklaronte: (i) mbi arsyet e kësaj transferte; (ii) burimin e krijimit të shumës së transferuar; (iii) marrëdhënien si person i lidhur me përfituesen e kësaj shume.

139. Trupi gjykues i kërkoi subjektin që deklarimi të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor dhe i kaloi barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 (për më shumë referojuni dosjes së rivlerësimit).

140. Në përgjigje të kësaj barre prove, subjekti shpjegon se bashkëshortja e tij Xh. B. ka qenë e punësuar përpara martesës me subjektin e rivlerësimit (datë 12.3.2010) me kohë të pjesshme gjatë viteve 2006 – 2009 me shtetasen E. Sh., e cila ka qenë e regjistruar në QKB dhe në organet tatimore si Person Fizik me emrin tregtar “E. Sh.” me NIPT ***, e vërtetuar kjo me vërtetimin e datës 10.3.2020 të lëshuar nga znj. E. Sh.. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur dijeni për kryerjen e kësaj transferte bankare dhe se bashkëshortja nuk ka kryer asnjëherë një veprim të tillë.

141. Subjekti sqaron për Komisionin se shtetasja J. B. është motra e shtetasës E. Sh. dhe jeton prej shumë vitesh në shtetin kanadez, e vërtetuar kjo me certifikatën familjare të familjes së shtetasit V. Xh., të lëshuar sipas Regjistrimit Themeltar të vitit 1974, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Nr. ***, të Bashkisë Tiranë, (bashkëngjitur këtij raporti).

142. Subjekti deklaroi se bashkëshortja e tij nuk e ka takuar asnjëherë këtë shtetase në jetën e saj. Thekson faktin se kjo llogari bankare është hapur vetëm për kryerjen e këtij veprimi të vetëm dhe nuk është përdorur asnjëherë tjetër nga bashkëshortja e tij për kryerjen e asnjë veprimi tjetër bankar.

143. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: “Pas jemi vënë në dijeni të faktit që shtetasja E. Sh. ka ndërruar jetë në datën 3.5.2021 të vërtetuar me Certifikatën e Vdekjes të datës 18.1.2022, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njesisë Administrative Nr. ***, të Bashkisë Tiranë, nga ana e shtetasit R. Sh. na është është lëshuar një Deklaratë Noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2022, ku është shprehur se: ‘Unë jam bashkëshorti i shtetasës E. Sh. (Xh.), e bija e V. dhe e M., datëlindje 2.12.1963, me numër personal ***, e cila ka ndërruar jetë në muajin maj të vitit 2021. Motra e shtetasës E. Sh. është shtetasja J. B. (Xh.), e bija e V. dhe e M., datëlindje 17.7.1969, me shtetësi shqiptare, me numër personal ***, aktualisht me vendqëndrim në Kanada.

*Pasi jam njohur me shkresën me nr. *** prot., datë 11.11.2021, të Bankës Amerikane të Investimeve (‘ABI Bank’), me vullnetin tim të lirë deklaroj se në vitin 2009 bashkëshortja ime E. Sh. ka transferuar një shumë të krijuar nga kursimet tona familjare për në Kanada te motra e saj J. B. me qëllim blerjen e një pasurie të paluajtshme në këtë shtet nga ana e kësaj shtetaseje. Një pjesë e kësaj shume parash në masën prej 19,302 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e dy) USD janë transferuar nga Banka Kombëtare e Greqisë, dega Shqipëri, (NBG), aktualisht ‘ABI Bank’.*

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se shtetasja Xh. M. (aktualisht B.), e cila ka punuar me kohë të pjesshme/me honorare me bashkëshorten time gjatë viteve 2006 – 2009 nuk ka asnjë pjesë/përqindje në shumën e parave të dërguara në shtetin kanadez te shtetasja J. B. dhe nuk ka kryer asnjë lidhje me shumën e dërguar nga Banka Kombëtare e Greqisë, dega Shqipëri, (NBG). Këto të ardhura kanë qenë kursime nga të ardhurat tona familjare”.

144. Në përfundim, trupi gjykues ka vlerësuar deklaratimet e subjektit dhe i ka vlerësuar ato në raport me rezultatet e hetimit dhe rrethanat e faktit, si dhe i ka pranuar ato si bindëse dhe që nuk mund të përbëjnë shkak për procesin e rivlerësimit të subjektit Ervin Beqiri.

145. *Depozitimi cash nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e babait të saj në shumën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.* Nga verifikimi i llogarisë së shtetasit F. M. (babai i bashkëshortes) në “Raiffeisen Bank”⁶³ rezulton se në këtë llogari, në datën 14.1.2011, është depozituar cash shuma 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga bashkëshortja e subjektit Xh. B..

146. Sa më sipër, Komisioni kërkon nga bashkëshortja e subjektit Xh. B./personi i lidhur të deklarojë mbi burimin e krijimit të kësaj shume të depozituar në llogarinë e shtetasit F. M..

147. Trupi gjykues i kërkoj subjektit që deklarimi të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor dhe i kaloi barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 (për më tepër referojuni dosjes së rivlerësimit).

148. Në përgjigje të kësaj barre prove, subjekti i rivlerësimit shpjegon se shtetasi F. M. është babai i shtetases Xh. B., bashkëshortes së tij, ndërsa shtetasi B. M. është vëllai i shtetasit F. M. dhe xhaxhai i shtetases Xh. B., e vërtetuar kjo me Certifikatën Familjare të lëshuar sipas Regjistrit Themeltar të vitit 1974, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) e Njesisë Administrative ***, Bashkia Gramsh.

149. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma e marrë fizikisht prej xhaxhait dhe ia ka dërguar babait të saj me anë të transfertës bankare dhe se nuk ka asnjë pjesë/përqindje në këtë shumë që është transferuar nëpërmjet transfertave bankare dhe se kjo ka qenë një marrëdhënie midis dy vëllezërve. Këto fakte janë vërtetuar edhe me deklaratat noteriale të lëshuara nga të dy këta shtetas, konkretisht, me Deklaratën Noteriale të shtetasit F. M. me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.1.2022, të dhënë përpara noterës G. H. të Dhomës së Noterisë Durrës është deklaruar se: *“Unë jam i ati i shtetases Xh. B.(M.) i datëlindjes 5.8.1982. Në vitin 2011, vajza ime, më ka dërguar nëpërmjet ‘Raiffeisen Bank’ një transfertë bankare në llogarinë time në shumën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Kjo shumë nuk është e vajzës sime Xh. B., po është një shumë e marrë hua te vëllai im B. M., me banim në Tiranë. Qëllimi i marrjes së kësaj huaje ishte për kryerjen e disa punimeve ndërtimore nga ana ime në banesën time në qytetin e Gramshit. Kjo shumë të hollash, thjeshtë për shpejtësi, është dërguar nëpërmjet transfertës bankare nga ana e vajzës sime tek unë.*

*Kjo shumë të hollash, e marrë hua nga ana ime, është kthyer po prej meje tek vëllai im B. M. në vitin 2014. Ky veprim u krye po me anë të transfertës bankare nëpërmjet ‘Raiffeisen Bank’. Këtë shumë e kam kthyer pasi unë mora nga shërbimi përmbartimor një dëmshpërblim monetar që e kam përfituar për largim të padrejtë nga puna në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë me nr. *** (***), datë 4.10.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe të ekzekutuar përfundimisht në vitin 2014”.*

150. Me Deklaratën Noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., të shtetasit B. M., datë 20.1.2022, të dhënë përpara noterës Dh. Q. të Dhomës së Noterisë Tiranë (bashkëngjitur këtij raporti) është deklaruar se: *“Deklaroj se në vitin 2011 i kam dërguar vëllait tim, shtetasit F. M. , i datëlindjes 23.3.1951, i cili jeton në qytetin e Gramshit shumën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, e cila i duhej për nevojat e tij personale. Këtë shumë unë ia kam dërguar me anë të vajzës së tij shtetases Xh. M. (B.). Deklaroj me vullnetin tim të lirë dhe me përgjegjësi të plotë se kjo shumë të hollash më është kthyer nga vëllai im F. M., në vitin 2014, po nëpërmjet vajzës së tij, e cila ma ka dorëzuar cash në qytetin e Tiranës”.*

151. Trupi gjykues ka pranuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortes.

⁶³Shkresa nr. *** prot., datë 6.5.2020, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.5.2020.

152. *Marrëdhënia e personit fizik "Xh. B.", me shoqërinë "****" sh.p.k.* Nga verifikimi i llogarisë bankare të personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit, në BKT⁶⁴, rezulton se për dy fatura të lëshuara në datën 30.12.2015 nga subjekti tregtar "Xh. B.", person fizik, ndaj shoqërisë "****" sh.p.k., në total për vlerën 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë është kryer pagesa nëpërmjet transferimit/kreditimit në bankë në datën 5.1.2016.

153. Si rrjedhim, shuma prej 600,000 (gjashtëqind mijë) lekësh, e përfituar nga personi fizik "Xh. B.", si rezultat i likuidimit të këtyre dy faturave, nuk do të reflektohet në analizën financiare si e ardhur për vitin 2015.

154. Për më tepër, rezulton se nga llogaria bankare e personit të lidhur në BKT, kjo shumë në datën 11.1.2016 është transferuar në llogari të shtetasës M. F.. Në vijim të verifikimeve të kryera, rezulton se në datën 17.10.2016, në llogarinë e personit të lidhur në BKT është kredituar nëpërmjet transfertës bankare shuma 500,000 (pesëqind mijë) lekë me përshkrimin "M. F., kthim shume kaluar në datën 11.1.2016".

155. Gjithashtu, rezulton se edhe në muajin shtator të vitit 2016, subjekti tregtar "Xh. B.", person fizik, ka lëshuar tri fatura tatimore⁶⁵ ndaj shoqërisë "****" sh.p.k., në total në shumën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, të cilat janë likuiduar nëpërmjet kreditimit në llogarinë bankare personale të personit të lidhur në "Credins Bank"⁶⁶, po në muajin shtator të vitit 2016.

156. Komisioni, për sa më sipër, i kërkoi të deklarojë: (i) mbi marrëdhënien e personit të lidhur me shtetasen M. F., arsyet e transferimit të shumës së sipërcituar, nëse kemi të bëjmë me marrëdhënie huaje, dhe nëse po, a është kthyer e gjithë shuma e huas së dhënë; (ii) nëse kjo shtetase ka lidhje me shoqërinë "****" sh.p.k.; (iii) mbi shërbimet e kryera nga personi fizik "Xh. B." në favor të shoqërisë "****" sh.p.k.; (iv) mbi shpjegime shteruese lidhur me këto transaksione, marrëdhënien e personit të lidhur me shtetasen M. F. dhe me shoqërinë "****" sh.p.k.

157. Trupi gjykues i kërkoi subjektin që deklarimi të shoqërohet me dokumentacion justifikues ligjor dhe i kaloi barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 (për më shumë referojuni dosjes së rivlerësimit).

158. Në përgjigje të kësaj barre prove, subjekti i rivlerësimit shpjegon se bashkëshortja Xh. B. njihet me shtetasen M. F. dhe kanë marrëdhënie shoqërore që në kohën e studimeve universitare pranë Universitetit Politeknik, Fakulteti i Ndërtimit, Tiranë. Gjithashtu, me bashkëshortin e saj të quajtur A. K. kanë raporte miqësie meqenëse janë nga e njëjta krahinë, ajo e Gramshit.

159. Shkaku për të cilën është bërë transfertë bankare për shtetasen M. F. ka qenë për arsyë mobilimi/arredimi në banesën e saj. Kjo shumë të hollash është kthyer plotësisht nga shtetasja M. F. brenda vitit 2016, po nëpërmjet transfertës bankare dhe në vërtetësi të këtij veprimi ka deklaruar me Deklaratën Noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.1.2022, përpara noteres M. D. se: "*Shtetasen Xh. B.(M.) e kam njohur që në vitin 2000, pasi kemi filluar bashkë studimet në të njëjtin vit akademik pranë Universitetit të Ndërtimit Tiranë, në degën e Inxhinierisë së Ndërtimit. Njëkohësisht ajo është dhe e afërme e bashkëshortit tim A. K., pasi janë nga e njëjta krahinë, ajo e Gramshit. Deklaroj se për shkak të marrëdhënieve shumë të mira personale dhe familjare me këtë shtetase dhe familjen e saj, në vitin 2015 ajo më ka transferuar një shumë prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh, të cilën unë e kam përdorur për nevoja të arredimit të banesës sime. Kjo shumë është transferuar pa asnjë interes. Deklaroj se këtë shumë kjo shtetase ma ka dhënë me anë të një transfertë bankare nëpërmjet Bankës*

⁶⁴Shkresa nr. ***, datë 15.12.2021, e BKT-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.12.2021.

⁶⁵Shihni materialet e dërguara me shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2021, të DRT-së Tiranë, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.11.2021.

⁶⁶Shkresa nr. *** prot., datë 17.8.2020, e "Credins Bank", protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.8.2020.

Kombëtare Tregtare. Këtë shumë të hollash unë ia kam kthyer të gjithë, po brenda vitit 2015, po me anë të transfertës bankare në të njëjtën bankë”.

160. Me shoqërinë “****” sh.p.k. bashkëshortja e subjektit Xh. B. ka pasur marrëdhënie biznesi për kryerjen e shërbimeve të caktuara për të cilat është e licencuar sipas ligjit.

161. Personi fizik “Xh. B.” ka bashkëpunuar me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe ka kryer shërbime në bazë të kontratave të shërbimit në vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2021 si inxhinier hidroteknike dhe vlerësuese e pasurive të paluajtshme.

162. Subjekti ka sqaruar se sipas statementit bankar të BKT-së, bashkëshortja i ka kaluar shtetases M. F. shumën 500,000 (pesëqind mijë) lekë, e cila është kthyer plotësisht më 17.10.2016. Shuma prej 100,000 (njëqind mijë) lekësh është tërhequr nga bashkëshortja dhe është përdorur për të shlyer pagesën e TVSH-së pranë organeve tatimore, vërtetuar me pagesën e kryer në “Raiffeisen Bank” të datës 20.1.2016, për këtë arsye kërkon që shuma 100,000 (njëqind mijë) lekë të zbritet nga bilanci negativ i vitit 2015. Në vijim, subjekti sqaron se: “Ajo është paguar rregullisht sipas ligjit për vitin 2015 dhe, konkretisht, për muajin dhjetor 2015 dhe është llogaritur nga organet tatimore si detyrim që duhet të paguhet në rolin e agjentit nga vlera e shtuar e personit fizik ‘Xh. B.’. Kjo e vërtetuar nga urdhërpagesa e datës 20.1.2016 për pagesën e TVSH-së për muajin dhjetor 2015, bashkë me mandatet përkatëse të kryera pranë ‘Raiffeisen Bank’, të cilat i janë bashkëngjitur këtij raporti”.

163. Për vlerën tjetër të faturave tatimore prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh subjekti shpjegon se bashkëshortja e tij ka nënshkruar në datën 5.6.2015 me shoqërinë “****” sh.p.k., në rolin e porositesit, kontratën e shërbimit me objekt “projekti hidroteknik strukturë magazinimi dhe prodhimi 1-kat dhe zyra 2-kat (***), studim, projektim i aksit Buzuq -Çorovodë etj., viti 2015” dhe në datën 11.7.2015 ka lidhur kontratën e shërbimit me objekt “për shërbime të vlerësimit të pasurive të paluajtshme”. Shumat ishin marrë si fond garancie/ parapagim për një projekt tjetër për të cilën është lidhur marrëveshja po në vitin 2015 me këtë shoqëri, të cilat i përkisnin personit fizik “Xh. B.”, e cila i dispononte këto shuma në gjendje *cash*. Gjatë vitit 2016, kur bashkëshortja ka kryer tërësisht projektet e saj ka faturuar shërbimin e kryer me fatura tatimore sipas ligjit. Pas faturimit të shërbimit dhe arkëtimit të saj, në të njëjtën kohë është kthyer prej bashkëshortes edhe vlera e marrë garanci nga shoqëria. Subjekti deklaroi se këto shuma ndonëse janë deklaruar në vitin 2015 i përkisnin vitit 2016.

164. Trupi gjykues, pasi ka analizuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, në raport dhe me rrethanat e faktit nuk ka dyshime për veprimtari që mund të krijojnë fshehje pasurie apo dyshime për hetime të mëtejshme dhe se ajo lidhet me marrëdhënien personale të punës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe veprime rutinë/ operacionale ditore të punës së saj.

- **Analiza financiare**

165. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur⁶⁷, për çdo vit, për periudhën para fillimit të detyrës, nga fillimi i detyrës – data 12.10.2009 deri më 31.12.2009, si edhe për vitet 2010 – 2016, nga ku duket se periudha nga fillimi i detyrës deri më 31.12.2009, si edhe vitet 2010, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, paraqiten me balancë negative të fondeve dhe, konkretisht: i) për periudhën 12.10.2009 – 31.12.2009 – balanca negative 64,475 lekë; ii) për vitin 2010 – balanca negative e fondeve 6,890 lekë; iii) për vitin 2011 – balanca negative e fondeve 891,948 lekë; iv) për vitin 2013 – balanca negative e fondeve 5,054,166 lekë; v) për

⁶⁷Në analizën financiare nuk janë përfshirë pasuritë, të ardhurat, shpenzimet, investimet e kryera të prindërve dhe motrave të subjektit të rivlerësimit – si persona të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

vitin 2014 – balanca negative e fondeve 172,738 lekë; vi) për vitin 2015 – balanca negative e fondeve 980,150 lekë.

166. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2009 dhe për vitet 2010, 2011, 2013, 2014 dhe 2015. Totali i balancës negative 2009 – 2016, në shumën 7,170,366 (shtatë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

167. Trupi gjykues i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me burimet e ligjshme që kanë shërbyer në analizën financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara dhe të rezultuara gjatë hetimit.

168. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet e tij lidhur me analizën financiare, të ardhurat dhe shpenzimet si në vijim.

169. Lidhur me analizën financiare deri në vitin 2013 ajo është rishikuar dhe arsyetuar më lart në vendim pasi është përdorur për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 104.18 m², në Tiranë. Situata negative financiare për krijimin e pasurisë rezulton në total -2,145,914 (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) lekë.

170. Në analizën financiare të vitit 2013 është parashikuar huadhënia në vlerën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë [megjithëse huadhënësi rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 687,991 (gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë], si dhe është parashikuar edhe kthimi i saj ndër vite (deri në vitin 2016). Në këtë vit nuk është marrë në konsideratë si burim huadhënia e deklaruar nga babai në shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë dhe as kthimi i saj, duke e konsideruar këtë burim të trajtuar më lart në vendim.

171. Lidhur me analizën financiare të vitit 2014 – 2015, subjekti i rivlerësimit sqaron se shuma e llogaritur si e ardhur nga paga për vitet 2014 - 2015 -2016 nuk përputhet me shumën respektive të pasqyruar në vërtetimet përkatëse nga institucioni i Prokurorisë.

172. Llogaritja e të ardhurave nga pagat janë kryer sipas arkëtimit të tyre në llogarinë bankare të subjektit. Pretendimi i subjektit nuk qëndron pasi vijon t'i referohet pagës së deklaruar në vërtetim dhe jo asaj të kredituar në bankë, në llogarinë e tij deri më 31 dhjetor.

173. Subjekti ka kërkuar që t'i zbriten shpenzimet jetike në vitin 2014 për vajzën e tij pasi ajo është vetëm disa muajshe dhe nuk mund të ketë të njëjtat shpenzime si një person i rritur.

174. Subjekti kërkon që të zbriten shpenzimet jetike për 13 ditë, në vitin 2014, kur rezulton që së bashku me bashkëshorten kanë qenë jashtë shtetit dhe këto shpenzime janë llogaritur një herë.

175. Shpenzimet e llogaritura nga Komisioni janë shpenzime minimale jetike dhe pretendimi i subjektit nuk është marrë në konsideratë për këto dy zëra.

176. Subjekti kërkon që në analizë financiare për vitin 2015 të përfshihet shuma 5,000 (pesë mijë) lekë si shpërblim nga Bashkia Tiranë për lindjen e fëmijës E. B.. Komisioni ka reflektuar këtë shumë si të ardhur në analizën e vitit 2015.

177. Lidhur me shpenzimet për udhëtime për në vendin e punës, subjekti kërkon që llogaritjet të bëhen për 11 muaj, pasi muaji gusht ka qenë pushim zyrtar dhe, për rrjedhojë, duhet të zbritet vlera 4,400 (katër mijë) lekë/vit.

178. Trupi gjykues ka përhurë në analizën financiare për vitin 2014 shpenzime sipas pretendimeve të subjektit, duke reflektuar ndryshimet përkatëse.

179. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja si person tregtar fizik, subjekti i rivlerësimit kërkon që në analizë financiare të vitit 2014 të përfshihen edhe pagat që ka përfutuar si e vetëpunësuar, konkretisht, duhet të llogaritet dhe një vlerë shtesë prej 154,000 (njëqind e pesëdhjetë e katërmijë) lekësh. Kjo shumë është njohur si një shpenzim që nuk është kryer në fakt, i cili duhet të zerohet/hiqet duke shtuar kështu fitimin për shtetasen Xh. B..

180. Lidhur me të ardhurat nga paga të bashkëshortes në vitin 2015, në vlerën gjithsej 165,000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë subjekti i rivlerësimit sqaron se bashkëshortes Xh. B. i janë bërë nga shoqëria “****” sh.p.k. për muajt janar - maj 2015 pagesa në masën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj, gjithsej në vlerën 75,000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë. Këto shuma janë paguar në datat 2.2.2015, 3.3.2015, 2.4.2015, 4.5.2015 dhe 2.6.2015 në llogarinë e BKT-së, ndërkohë që nga shoqëria “****” sh.p.k. për muajt qershor - nëntor 2015 është kryer pagesa gjithsej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Kjo diferencë me pagesat që janë konstatuar nga Komisioni është shkaktuar për shkak se nga shoqëria “****” sh.p.k. një pagesë në vlerën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë është kryer në datën 8.9.2015, në llogarinë bankare të personit fizik tregtar “Xh. B.” pranë “Credins Bank” sh.a. Dy pagesa janë kryer në llogarinë personale të shtetasen Xh. B. pranë “Credins Bank” dhe, konkretisht, në datën 3.12.2015, në masën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe në datën 17.12.2015, në masën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh, kurse një pagesë është kryer cash dhe për të cilën janë paguar edhe sigurimet shoqërore.

181. Trupi gjykues ka pranuar dhe përfshirë në analizën e viteve 2014 - 2015 këto të ardhura.

182. Subjekti i rivlerësimit deklaron se vlera 111,317 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë, e përlllogaritur si shpenzim i kryer për udhëtimin në shtetin grek në vitin 2015 nuk përputhet me shpenzimet e tyre të pretenduara në vlerën 26,097 (njëzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë. Për këtë udhëtim të kryer ka qëndruar te djali i tezes së vet, P. M., vërtetuar me Deklaratën Noteriale të tij me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2020. Për sa më sipër, subjekti kërkon që vlera 85,220 (tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet) lekë të zbritet nga analiza financiare negative e vitit 2015.

183. Komisioni ka reflektuar se pretendimet e subjektit, duke pakësuar shpenzimet e udhëtimit në Greqi te i afërm i subjektit, duke llogaritur kostot e qëndrimit me 5 euro/dita sipas Kolegjit.

Analiza financiare për periudhën 2014-2015:

Vitet	2014	2015
Pasuri Neto	-999.513	-796
Ndryshim Likuiditeti	-999.513	-796
TE ARDHURA	2.052.846	2.297.449
Të ardhura nga paga SR	1.063.352	1.036.120
Të ardhura nga paga B/shortja	35.000	255.000
Të ardhura nga ISSH B/shortja	121.318	-
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	17.999	-
Të ardhura nga paga si e vetpunësuar e b/shortes	115.296	264.000
Të ardhura/fitime nga PF Xh. B.	699.881	737.329
Te ardhura nga Bashkia per bebe	-	5.000
SHPENZIME	3.064.295	2.832.676
Shpenzime minimale jetike	636.487	672.828
Shpenzim për pagesën e kështit të III ndaj ***	980.770	0
Shpenzime për shlyerje huaje ndaj babait A. B.	1.100.000	1.400.000
Shpenzime për arredimin e shtëpisë		500.000
Shpenzime për udhëtimet jashtë vendit	302.638	24.598
Shpenzime te tjera (qiraje /udhëtimin në pune/ per lic. Avokatit ne Itali)	44.400	235.250
Balanca e Fondeve	-11.936	-534.430

184. Në përfundim të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit rezulton në një situatë negative në shumën -2,145,914 (dy milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) lekë deri në vitin 2013, që lidhet me krijimin e pasurisë apartament në Tiranë dhe në vlerën

negative -534,430 (pesëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë) lekë, në total, për vitet 2014 - 2015.

185. Në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë, pas vlerësimit të rezultateve të hetimit në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të barrës së provës, si dhe vlerësimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë hetimit dhe akteve të administruara në vijim të barrës së provës dhe dëgjimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues i Komisionit arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për një pjesë të tyre. Trupi gjykues i vlerëson këto konkluzione si të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

186. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe se ai dhe huadhënësi nuk kanë burime të ligjshme, të cilat të përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 3.3.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku